



**RAPORT VJETOR PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR
PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT DHE KONFLIKTIT TË INTERESIT 2021–2025**
për periudhën nga 01.01.2025 deri më 31.12.2025

Shkup, mars 2026

1. HYRJE.....	5
2. REZYME EKZEKUTIVE	7
3. FUSHA HORIZONTALE PROKURIMET PUBLIKE	11
4. FUSHA HORIZONTALE PUNËSIMI	15
5. SEKTORI I SISTEMIT POLITIK.....	25
6. SEKTORI I GJYQËSORIT	31
7. SEKTORI ORGANET PËR ZBATIMIN E LIGJIT.....	38
8. SEKTORI I SHËNDETËSISË	47
9. SEKTORI I ARSIMIT.....	59
10. SEKTORI PËR PUNË DHE POLITIKË SOCIALE	72
11. SEKTORI PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM HAPËSINOR	77
12. SEKTORI I MJEDISIT JETËSOR	79
13. SEKTORI I BUJQËSISË	82
14. SEKTORI I SPORTIT.....	89
15. SEKTORI I EKONOMISË DHE BIZNESIT	97
16. SEKTORI I NP DHE SHA NË PRONËSI TË SHTETIT DHE NJVL-të	106
17. SEKTORI PËR MEDIA DHE SHOQËRI CIVILE	112

Lista e shkurtesave

Shkurtesa	Emërtimi i plotë
AKP	Agjencia për Kadastër të Patundshmërive
AMFBZHR	Agjencia e Mbështetjes Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural
ACAL	Agjencia për Cilësi në Arsimin e Lartë
MALMED	Agjencia e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore
ARS	Agjencia për Rini dhe Sport
MS	Ministria e Sporteve
AQLI	Agjencia e Mbrojtës të së Drejtës për Qasje të lirë në Informata me Karakter Publik
APN	Agjencia për Përkrahjen e Ndërmarrësisë
AGJPP	Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publik
BPP	Byroja për Prokurime Publike
BZHA	Byroja e Zhvillimit të Arsimit
QRMV	Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut
KSHPK	Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit
ISHB	Inspektorati Shtetërorë për Bujqësi
ISHA	Inspektorati Shtetëror i Arsimit
ISHA	Inspektorati Shtetëror Administrativ
NJVL	Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale
SHGM	Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë
SHPB	Shoqata e prokurorëve publik
PPRMV	Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut
MPB	Ministria për Punë të Brendshme
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MBPEU	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujrave
ME	Ministria e Ekonomisë
MEP	Ministria e Ekonomisë dhe Punës
MEMLP	Ministria e Energjisë, Minerave dhe Lëndëve të Para
MSHIA	Ministria e Shoqërisë së Informacionit dhe Administratës
MAP	Ministria e Administratës Publike
MTD	Ministria e Transformimit Dixhital
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MD	Ministria e Drejtësisë
MPPS	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
MPSDR	Ministria e Politikës Sociale, e Demografisë dhe e të Rinjve
MF	Ministria e Financave
MTL	Ministria e Transportit dhe Lidhjeve
MT	Ministria e Transportit
SK 2021-2025/Strategjia	Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit 2021-2025
Kuvendi	Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut
KEMM	Këshilli për Etikë në Media në Maqedoni
DPF	Drejtorja e Policisë Financiare
DIF	Drejtorja për Intelejencë Financiare
FSSH	Fondi i Sigurimit Shëndetësor
FSPRMV	Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor i Republikë së Maqedonisë së Veriut
DD	Drejtorja e Doganave
LPKKI	Ligji për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit
UGD	Universiteti “Goce Delçev” Shtip
UKLO	Universiteti “ Shën Klimenti i Ohrit” – Manastir

UNT	Universiteti “Nën Tereza” në Shkup
USHIT	Universiteti për Shkenca Informative dhe Teknologji “Shën Apostul Pali” – Ohër
KI	Këshilli i Inspektorëve
LOFOASH	Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Organeve të Administratës Shtetërore

1. HYRJE

Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit 2021–2025

Lufta kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesit përbën një nga prioritetet kryesore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në drejtim të forcimit të sundimit të ligjit, demokracisë dhe transparencës institucionale. Për këtë qëllim, në vitin 2019 u miratua Ligji për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, i cili vendos mekanizma të qartë për parandalimin, zbulimin dhe pengimin e praktikave korruptive në të gjitha sferat e jetës shoqërore.

Me këtë ligj përcaktohen detyrimet dhe mekanizmat për:

- parandalimin e korrupsionit gjatë ushtrimit të pushtetit, autorizimeve publike, detyrave zyrtare dhe funksioneve politike;
- identifikimin, parandalimin dhe menaxhimin e konfliktit të interesit;
- zvogëlimin e praktikave korruptive në subjektet juridike që janë të lidhura me autorizimet publike;
- forcimin e kapaciteteve institucionale për luftën kundër korrupsionit përmes politikave, masave dhe aktiviteteve përkatëse;
- avancimin e transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjësisë së institucioneve në nivel qendror dhe lokal;
- vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga korrupsioni në sektorë të ndryshëm; dhe
- ndërtimin e kulturës së etikës dhe integritetit në administratën publike, sektorin e biznesit dhe shoqërinë civile.

Sipas ligjit, për zbatimin e masave për luftën kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesit është përgjegjëse Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK). Si institucion i pavarur dhe autonom, KSHPK është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të sistemit të integritetit, hartimin e dokumenteve strategjike kundër korrupsionit dhe ndërmarrjen e masave konkrete në drejtim të parandalimit të korrupsionit dhe ndikimit të tij mbi institucionet dhe qytetarët.

Strategjia aktuale kombëtare për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit 2021–2025 u miratua më 10 dhjetor 2020, ndërsa u aprovua nga Kuvendi në prill 2021. NS2021–2025 përfaqëson një dokument thelbësor dhe afatmesëm që synon të sigurojë një qasje sistematike në trajtimin e korrupsionit.

Strategjia është rezultat i një analize të thelluar të rreziqeve nga korrupsioni dhe është hartuar përmes një procesi gjithëpërfshirës konsultimesh me përfaqësues nga sektori publik dhe privat, mediat, organizatat e shoqërisë civile, komuniteti akademik dhe institucione relevante ndërkombëtare. Strategjia bazohet në sfidat dhe dobësitë e identifikuara në sistemin institucional dhe normativ dhe jep udhëzime të qarta për tejkalimin e tyre. Dokumenti përmban një Plan të detajuar të Veprimit, në të cilin janë përcaktuar masa konkrete, aktivitete dhe indikatorë për monitorimin e progresit në luftën kundër korrupsionit.

Problemet dhe masat janë sistematizuar në dy fusha horizontale dhe trembëdhjetë sektorë prioritarë:

- **Fushat horizontale:** prokurimet publike dhe punësimi;
- **Sektorët prioritarë:** sistemi politik, gjyqori, organet e zbatimit të ligjit, shëndetësia, arsimi, puna dhe politika sociale, urbanizmi dhe planifikimi hapësinor, mjedisi jetësor, bujqësia, sporti, ekonomia dhe biznesi, ndërmarrjet publike dhe shoqëritë aksionare në pronësi shtetërore, mediat dhe shoqëria civile.

Sipas nenit 18 paragrafi 6 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit (LPKKI), KSHPK ka obligim të ndjekë zbatimin e masave të Strategjisë dhe të përgatisë raporte vjetore, të cilat më së voni deri më 31 mars të vitit aktual për vitin paraprak i dorëzohen Kuvendit. Këto raporte mundësojnë vlerësim sistematik të aktiviteteve të zbatuara, identifikim të rezultateve të arritura, si dhe propozim-masa/rekomandime për përmirësimin e luftës kundër korrupsionit.

Ky raport përfaqëson shqyrtimin e pestë vjetor të progresit në zbatimin e Strategjisë, përkatësisht mbulon periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2025. Raportet vjetore të mëparshme për vitet 2021, 2022, 2023 dhe 2024 janë dorëzuar brenda afatit të parashikuar me ligj dhe janë të qasshme publikisht në faqen e internetit të KSHPK-së.

Struktura e raportit përfshin:

- përmbledhje të gjetjeve kryesore;
- dy pjesë të dedikuara fushave horizontale dhe
- 13 pjesë që trajtojnë në detaje gjendjen dhe sfidat për secilin nga sektorët prioritarë.

Në çdo pjesë të raportit paraqiten gjetjet për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit, së bashku me analizën e të dhënave statistikore dhe vlerësimin e nivelit/statusit të realizimit (të realizuara, të përealizuara dhe në zhvillim e sipër).

Raporti paraqet një bazë analitike për vlerësimin e efektivitetit të politikave dhe masave të përcaktuara në Strategji deri në vitin 2025, me qëllim përmirësimin sistematik të transparencës, llogaridhënies dhe integritetit në funksionimin institucional dhe shoqëror.

Metodologjia

Raporti vjetor bazohet në informacionet e dorëzuara nga institucionet kompetente për shkallën e realizimit të aktiviteteve gjatë vitit 2025, në përputhje me Planin e Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit 2021–2025. Në bazë të raporteve të vendosura në aplikacionin ueb nga koordinatorët institucionalë, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit ka kryer analizën dhe në janar 2026 ka përcaktuar statusin përfundimtar të aktiviteteve (të realizuara, të përealizuara dhe ato në zhvillim e sipër).

Duke pasur parasysh se në Planin e Veprimit për zbatimin e NS2021–2025 nuk është parashikuar asnjë aktivitet me afat realizimi veçanërisht në vitin 2025, objekt i këtij vlerësimi ishin:

- aktivitetet me afat të parashikuar realizimi në vitet 2021, 2022, 2023 dhe 2024, të cilat në vlerësimin e mëparshëm ishin shënuar si “në zhvillim e sipër” ose “të përealizuara”;
- aktivitetet në kontinuitet, të cilat janë objekt vlerësimi çdo vit.

Gjatë analizës së realizimit të aktiviteteve, vlerësimi i referohet aktiviteteve të institucionit që është përcaktuar si bartës kryesor i atij aktiviteti. Edhe pse një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve kërkojnë bashkëpunim ndërinstitutional, ato paraqiten në kuadër të institucionit që në Planin e Veprimit është shënuar si përgjegjës/kompetent.

Miratimi i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore (“Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr. 121/24) solli ndryshime në strukturën institucionale dhe kompetencat e organeve të administratës shtetërore në periudhën e mëparshme të vlerësimit. Edhe pse aktivitetet në raport paraqiten sipas institucioneve që kanë qenë kompetente para këtyre ndryshimeve, ndikimi i strukturës së re institucionale mbetet relevant edhe në këtë periudhë raportuese, përkatësisht për zbatimin e një pjese të aktiviteteve gjatë vitit 2025.

2. REZYME EKZEKUTIVE

Në kuadër të Strategjisë janë identifikuar 54 probleme kryesore, për realizimin e të cilave janë parashikuar 111 masa dhe 191 aktivitete konkrete. Nga numri i përgjithshëm i aktiviteteve, 34 janë të klasifikuara si aktivitete në kontinuitet, që do të thotë se zbatimi i tyre është objekt vlerësimi çdo vit pas fillimit të tyre.

Shpërndarja e problemeve, masave dhe aktiviteteve është si vijon:


Numri rendor	Fusha/ sektori	Problemi	Masat	Aktivitetet
1.	Prokurime publike	2	2	4
2.	Punësim	3	8	13
3.	Sistem politik	6	7	8
4.	Gjyqësorë	3	7	14
5.	Organet për zbatimin e ligjit	7	13	21
6.	Shëndetësi	5	18	26
7.	Arsim	8	18	34
8.	Punë dhe politikë sociale	1	5	10
9.	Urbanizëm dhe planifikim hapsinor	1	1	1
10.	Mjedisi jetësor	1	1	2
11.	Bujqësi	5	9	16
12.	Sport	2	6	15
13.	Ekonomi dhe biznes	4	8	13
14.	NP dhe SHA	3	3	6
15.	Media dhe shoqëri civile	3	5	8
Gjithsej		54	111	191

Tabela 1: Paraqitje tabelare e numrit të përgjithshëm të problemeve, masave dhe aktiviteteve sipas fushave/ sektorëve në Strategji

Numri i problemeve të identifikuar, si dhe i masave dhe aktiviteteve të përcaktuara sipas sektorëve, varet kryesisht nga niveli i rrezikut të identifikuar të korrupsionit në secilën nga fushat/ sektorët. Përveç kësaj, një rol të rëndësishëm në përcaktimin e masave ka pasur edhe përfshirja dhe kontributi i institucioneve brenda çdo sektori gjatë procesit të përgatitjes së Strategjisë në vitin 2019.

Analiza e shpërndarjes së problemeve, masave dhe aktiviteteve tregon se vëllimi i tyre varet nga rreziqet e identifikuar të korrupsionit, shkalla e përfshirjes së institucioneve gjatë përgatitjes së Strategjisë dhe kompleksiteti i problemeve. Numri më i madh i masave dhe aktiviteteve është parashikuar në sektorët tradicionalisht të ekspozuar ndaj rreziqeve më të larta të korrupsionit, si gjyqësori, shëndetësia, arsimi dhe organet e zbatimit të ligjit, me qëllim uljen e korrupsionit dhe forcimin e mekanizmave për parandalim dhe sanksionim.

Problemet sipas **fushave/ sektorëve**:



Fotografia 1: Numri i problemeve, masave dhe aktiviteteve sipas fushave/sektorëve

Rreth 40% e të gjitha masave dhe aktiviteteve i referohen sektorëve të arsimit, shëndetësisë dhe organeve për zbatimin e ligjit.

Shpërndarja e **aktiviteteve sipas viteve** është si vijon:



Fotografia 2: Shpërndarja në përqindje e aktiviteteve sipas viteve

Shpërndarja e aktiviteteve sipas viteve tregon se numri më i madh i aktiviteteve janë parashikuar për vitin e parë të implementimit:

Shpërndarja në përqindje e aktiviteteve sipas viteve është si vijon:

- 110 aktivitete (58%) kanë qenë të parashikuar për vitin 2021;
- 70 aktivitete (36%) kanë qenë të parashikuar për vitin 2022;
- 9 aktivitete (5%) kanë qenë të parashikuar për vitin 2023;
- 2 aktivitete (1%) janë parashikuar për vitin 2024; dhe
- për vitin 2025 nuk është parashikuar asnjë aktivitet i ri.

Për më tepër, 27 aktivitete nga Plani i Veprimit kanë zbatim në kontinuitet për të gjithë periudhën 2021–2025, gjashtë aktivitete kanë filluar në kontinuitet në vitin 2022, ndërsa një aktivitet është parashikuar në kontinuitet nga viti 2024. Numri i përgjithshëm i aktiviteteve që duhet të realizohen në periudhën 2021–2025 është 318.

Gjatë përcaktimit të afateve për realizimin e aktiviteteve, një rol të rëndësishëm kanë pasur vetë institucionet dhe pjesëmarrësit nga sektorët përkatës, gjë që ka siguruar një qasje realiste në planifikimin dhe prioritizimin e masave për parandalimin e korrupsionit.

Gjendja e numrit të **aktiviteteve sipas fushave/sektorëve**, që janë objekt i vlerësimit në vitin 2025, është si vijon:

Fusha/sektori	Numri i përgjithshëm i aktiviteteve për vlerësim në vitin 2025	Aktivitetet e parashikuara për vitin 2025	Aktivitetet e bartura nga vitet 2021, 2022, 2023 dhe 2024
Prokurime publike	3	0	3
Punësim	11	0	11
Sistem politik	7	0	7
Gjyqësor	8	0	8
Organe për zbatimin e ligjit	15	0	15
Shëndetësi	13	0	13
Arsim	21	0	21
Punë dhe politikë sociale	5	0	5
Urbanizëm dhe planifikim hapsinor	1	0	1
Mjedis jetësor	2	0	2
Bujqësi	14	0	14
Sport	14	0	14
Ekonomi dhe biznes	13	0	13
NP dhe SHA	5	0	5
Media dhe shoqëri civile	5	0	5
Gjithsej	137	0	137

Tabela 2: Pasqyrë tabelare sipas fushave/sektorëve e numrit të aktiviteteve për vlerësimin aktual – numri i aktiviteteve për vlerësim në vitin 2025 dhe numri i aktiviteteve të bartura nga vitet e mëparshme.

Në vitin 2025 nuk janë parashikuar aktivitete të reja, që do të thotë se të gjitha 137 aktivitetet janë të bartura nga vitet e tjera, të cilat kanë mbetur me status “në zhvillim e sipër” ose “të parrealizuara”, si dhe aktivitetet në kontinuitet. Nga këto, 34 janë aktivitete janë në kontinuitet, ndërsa 103 përbëjnë aktivitete që në vlerësimet e mëparshme janë shënuar si “në zhvillim e sipër” ose “të parrealizuara”.

Pas vlerësimit të raporteve të dorëzuara dhe përcaktimit të statusit përfundimtar të realizimit të aktiviteteve, pasqyra sipas **fushave/sektorëve për vitin 2025** është si vijon:

Fusha/sektori	Aktivitete të realizuara	Aktivitete të parrealizuara	Në zhvillim e sipër
Prokurime publike	1	0	2

Punësim	1	5	5
Sistem politik	0	4	3
Gjyqësor	4	2	2
Organe për zbatimin e ligjit	1	8	6
Shëndetësi	3	3	7
Arsim	6	8	7
Punë dhe politikë sociale	1	2	2
Urbanizëm dhe planifikim hapësinor	1	0	0
Mjedis jetësor	0	0	2
Bujqësi	4	10	0
Sport	1	9	4
Ekonomi dhe biznes	6	4	3
NP dhe SHA	0	4	1
Media dhe shoqëri civile	2	1	2
Gjithsej	31	60	46

Tabela 3: Pasqyrë e aktiviteteve të realizuara, të përpilizuara dhe në zhvillim e sipër për vitin 2025 sipas fushave/sectorëve.

Analiza e të dhënave të kryera tregoi:

Shkalla e realizimit të aktiviteteve në vitin 2025. Nga gjithsej 137 aktivitete të vlerësuara për vitin 2025, 31 aktivitete janë realizuar (23%), 60 aktivitete janë të përpilizuara (44%), ndërsa 46 aktivitete janë në zhvillim e sipër (33%).

Analiza sipas fushave/sectorëve

Realizimi më i lartë vërehet në sektorët e arsimit dhe ekonomisë dhe biznesit, ku ka nga 6 aktivitete të realizuara. Realizimi më i ulët vërehet në sektorët e sistemit politik, mjedisit jetësor dhe ndërmarrjeve publike dhe shoqërive aksionare (NP dhe SHA). Në disa sektorë, veçanërisht në urbanizëm dhe planifikim hapësinor, numri i aktiviteteve të përpilizuara është i lartë, gjë që tregon mungesë progresi ose bllokim të proceseve.



Fotografia 3: Paraqitje grafike e shkallës së realizimit në vitin 2025

3. FUSHA HORIZONTALE PROKURIMET PUBLIKE

Përshkrimi i fushës horizontale

Problemet prioritare në fushën horizontale të prokurimeve publike janë:

- 1) Numër i pamjaftueshëm i personave me kualifikime adekuate dhe njohuri të standardeve gjatë përcaktimit të specifikimeve teknike, si dhe kriterëve për vlerësimin e aftësisë së operatorëve ekonomikë; dhe
- 2) Transparencë e pamjaftueshme e institucioneve dhe nivel i ulët i integritetit të personave të përfshirë në zbatimin e prokurimeve publike.

Institucionet përgjegjëse për realizimin e masave dhe aktiviteteve për tejkalimin e problemeve në fushën e prokurimeve publike janë:

- 1) Byroja për Prokurime Publike (në tekstin e mëtejshëm: BPP),
- 2) Ministria e Financave (në tekstin e mëtejshëm: MF) dhe
- 3) Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informacionet me Karakter Publik (në tekstin e mëtejshëm: AQLI).

Shkalla e realizimit të aktiviteteve në fushën përkatëse

Në fushën horizontale të prokurimeve publike, për tejkalimin e dy problemeve në periudhën raportuese janë parashikuar dy masa dhe tre aktivitete. Bazuar në të dhënat e marra dhe analizat e kryera për këtë fushë, gjendja e realizimit të aktiviteteve të përcaktuara me Planin e Veprimit të Strategjisë për vitin 2025 është si vijon:

Problemi 1: Numër i pamjaftueshëm i personave me kualifikime adekuate dhe njohuri të standardeve gjatë përcaktimit të specifikimeve teknike, si dhe kriterëve për vlerësimin e aftësisë së operatorëve ekonomikë								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Forcimi i kapaciteteve të personave që përgatisin dokumentacionin e tenderëve.	1.1. Hartimi dhe zbatimi i trajnimeve për zbatimin e standardeve gjatë përgatitjes së specifikimeve teknike dhe kriterëve për vlerësimin e aftësisë, me pjesëmarrjen e Institutit të Standardizimit.	BPP Institut për standardizim	Gjysma e dytë e vitit 2021 - në kontinuitet	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	E realizuar	E realizuar
Problemi 2: Transparencë e pamjaftueshme e institucioneve dhe nivel i ulët i integritetit të personave të përfshirë në zbatimin e prokurimeve publike								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Rritja e integritetit institucional dhe transparencës në prokurimet publike.	1.1 Ndryshimi i Ligjit për prokurime publike për përcaktimin e detyrueshëm të nënshkrimit të deklaratës së konfidencialitetit nga personat që marrin pjesë në përgatitjen e specifikimit teknik.	MF BPP	Gjysma e parë e vitit 2023	E pamaturuar	E pamaturuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
	1.2. Në modelet e dokumentacionit të tenderëve që i përgatit BPP, detyrimisht të përcaktohen personat e autorizuar për pranimin e raporteve për mbrojtjen e raportimit të brendshëm dhe të jashtëm nga sinjalizuesit, në lidhje me korrupsionin në prokurimet publike.	BPP	Gjysma e dytë e vitit 2020	E realizuar	/	/	/	/
	1.3. Forcimi i mbikëqyrjes në lidhje me publikimin e informacioneve për prokurimet publike, në përputhje me nenin 10 të Ligjit për qasje të lirë në informacionet me karakter publik.	AQLI	Gjysma e parë e vitit 2021 - në kontinuitet	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër


Për realizimin e Problemit 1: “Numër i pamjaftueshëm i personave me kualifikime adekuate dhe njohuri të standardeve gjatë përcaktimit të specifikimeve teknike, si dhe kriterëve për vlerësimin e aftësisë së operatorëve ekonomikë”, është parashikuar Masa 1: “Forcimi i kapaciteteve të personave që përgatisin dokumentacionin e tenderëve”. Për këtë masë është parashikuar një aktivitet: Aktiviteti 1.1 –Hartimi dhe zbatimi i trajnimeve për zbatimin e standardeve gjatë përgatitjes së specifikimeve teknike dhe kriterëve për vlerësimin e aftësisë, me pjesëmarrjen e Institutit të Standardizimit për të cilin afati i realizimit ka qenë gjysma e dytë e vitit 2021 dhe në kontinuitet, ndërsa institucioni përgjegjës është BPP. Ky aktivitet është në proces të vazhdueshëm realizimi. Konkretisht, komunikimi i vendosur ndërmjet Byrosë për Prokurime Publike dhe Institutit të Standardizimit në lidhje me aktivitetet e përbashkëta vazhdon, pa ndryshime shtesë në politikat e standardizimit në fushën e prokurimeve publike. KSHPK rekomandon që ky bashkëpunim i vazhdueshëm ndërmjet Byrosë për Prokurime Publike dhe Institutit të Standardizimit të vijojë edhe në të ardhmen, me qëllim ndjekjen e trendeve dhe përmirësimin e standardeve gjatë përgatitjes së specifikimeve teknike dhe kriterëve për vlerësimin e aftësisë së operatorëve ekonomikë.

Në lidhje me **Problemin 2: Mungesa e transparencës së institucioneve dhe niveli i ulët i integritetit të personave të përfshirë në zbatimin e prokurimeve publike**, është parashikuar Masa 1: “Rritja e integritetit institucional dhe transparencës në prokurimet publike”, me tre aktivitete, nga të cilat për këtë periudhë raportuese janë parashikuar dy:

- Aktiviteti 1.1 *Ndryshimi i Ligjit për prokurimet publike për përcaktimin e detyrueshëm të nënshkrimit të deklaratës së konfidencialitetit nga personat që marrin pjesë në përgatitjen e specifikimeve teknike, me afat realizimi në gjysmën e parë të vitit 2023*, ndërsa bartës është MF. Sipas raportit të dorëzuar, aktiviteti është “**në zhvillim e sipër**”. MF e ka shënuar këtë aktivitet si në zhvillim e sipër, duke marrë parasysh se në raport theksohet se Byroja e Prokurimeve Publike ka ndërmarrë aktivitete në drejtim të analizës dhe identifikimit të dispozitave të Ligjit për prokurimet publike që duhet të ndryshohen, si dhe ka filluar përgatitjen e një forme të Deklaratës së Konfidencialitetit që duhet të parashikohet me ndryshimet. Ky aktivitet do të konsiderohet me status në zhvillim e sipër deri në realizimin e tij përmes miratimit të ndryshimeve përkatëse ligjore.
- Aktiviteti 1.3 *Forcimi i mbikëqyrjes lidhur me publikimin e informacioneve për prokurimet publike, në përputhje me nenin 10 të Ligjit për qasje të lirë në informacionet me karakter publik*. Afati për realizimin e këtij aktiviteti është **gjysma e parë e vitit 2021** në kontinuitet, ndërsa bartës i aktivitetit është AQLI. Ky aktivitet ka status “**në zhvillim e sipër**”, për arsye se AQLI informon se në Ligjin për qasje të lirë në informacionet me karakter publik nuk janë parashikuar dispozita për kundërvajtje për zbatimin e sanksioneve konkrete lidhur me mos publikimin e të dhënave të cilat përmenden në këtë aktivitet, ndërsa KSHPK konsideron se Ligji për qasje të lirë në informacionet me karakter publik përmban dispozita për kundërvajtje të cilat sanksionojnë mos publikimin e informacioneve në lidhje me prokurimet publike, në përputhje me nenin 10 të ligjit. Respektivisht në nenin 10 të këtij ligji janë përcaktuar informacionet që poseduesit e informacionit detyrimisht duhet t’i publikojnë në faqen e internetit, ndërsa në alinenë 18 është përcaktuar detyrimi për publikimin e të gjithë dokumentacionit për prokurimet publike, koncesionet dhe kontratat për partneritet publik-privat. Me dispozitat e nenit 39, alineja 2 të këtij ligji, është përcaktuar se gjobë në shumë prej 250 euro në kundërvlerë në denarë do t’i shqiptohet zyrtarit përgjegjës te poseduesi i informacioneve nëse nuk e mban dhe nuk e përditëson rregullisht listën e informacioneve që disponon dhe nuk e publikon atë në mënyrë të duhur, të qasshme për kërkuesin, në përputhje me nenin 9 të këtij ligji. Megjithatë, ekzistojnë pengesa që kufizojnë shqiptimin e gjobave për mos publikimin e të dhënave dhe të njëjtat duhet të tejkalohen.


Në bazë të të dhënave të marra dhe të vlerësuara nga institucionet kompetente, dhe shqyrtimin dhe verifikimin nga ana e Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK), niveli i

përgjithshëm i realizimit të aktiviteteve nga miratimi i Strategjisë deri më sot në fushën e prokurimeve publike është si vijon:




Fotografia 4: Niveli i përgjithshëm i realizimit në fushën përkatëse

Nga gjithsej katër aktivitetet e parashikuara në Strategjinë për këtë fushë horizontale, dy aktivitete janë realizuar (50%), ndërsa dy janë në zhvillim e sipër (50%).



Fotografia 5: Statusi i realizimit të aktiviteteve sipas viteve



Fotografia 6: Statusi i aktiviteteve sipas institucioneve

- BPP është bartës i dy aktiviteteve, dhe të dyja janë të realizuara.
- AQLI është bartës i një aktiviteti, i cili është në zhvillim e sipër.
- MF është bartës i një aktiviteti, i cili është në zhvillim e sipër.

4. FUSHA HORIZONTALE PUNËSIMI

Përshkrimi i fushës horizontale

Problemet prioritare në fushën horizontale të punësimit janë:

- 1) Mospërputhja e një numri të madh ligjesh që rregullojnë punësimin, gjë që mundëson çdo lloj ndikimi: ndikim partiak, nepotizëm, kronizëm dhe klientelizëm;
- 2) Menaxhim, udhëheqje dhe mbikëqyrje joefikase në disa organe të administratës, agjenci, ndërmarrje publike dhe shoqëri aksionare në pronësi shtetërore;
- 3) Legjislacioni nuk ka vendosur një sistem të qartë për vlerësimin e kriterëve të përzgjedhjes në procesin e punësimit dhe avancimit në sektorin publik.

Institucionet kompetente për realizimin e masave dhe aktiviteteve për tejkalimin e problemeve në fushën e punësimit janë:

- 1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në vijim: Qeveria),
- 2) Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit,
- 3) Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës (në vijim: MSHIA)
- 4) Ministria e Ekonomisë (në vijim: ME),
- 5) Ministria e Vetëqeverisjes Lokale (në vijim: MVL),
- 6) Ministria e Shëndetësisë (në vijim: MSH),
- 7) Ministria e Arsimit dhe Shkencës (në vijim: MASH)
- 8) Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (në vijim: MPPS),
- 9) Ministria e Kulturës (në vijim: MK),
- 10) Ministrinë e tjera (në vijim: ministrinë)
- 11) Komunitat dhe Qyteti i Shkupit (në vijim: NJVL-të), dhe
- 12) Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informacionet me Karakter Publik (në vijim: AQLI).

Shkalla e realizimit të aktiviteteve në fushën përkatëse

Në fushën horizontale të punësimit, për tejkalimin e tre problemeve prioritare në periudhën raportuese janë parashikuar tetë masa dhe 11 aktivitete. Pjesa më e madhe e këtyre aktiviteteve ka qenë e planifikuar të realizohen në vitin 2021, ndërsa nga të dhënat e marra dhe analizat e kryera statusi i tyre është përcaktuar si vijon:

Problemi 1: Mospërputhja e një numri të madh ligjesh që rregullojnë punësimin, gjë që mundëson çdo lloj ndikimi: ndikim partiak, nepotizëm, kronizëm dhe klientelizëm.								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Heqja e mundësisë për punësim përmes agjencive për punësime të përkohshme dhe e mundësisë që punësimet e përkohshme të transformohen në punësim me kohë të pacaktuar pa procedurë të rregullt punësimi.	1.1. Ndryshimi i Ligjit për të Punësuarit në Sektorin Publik me qëllim të heqjes së mundësisë për punësim përmes agjencive për punësime të përkohshme dhe për transformimin e marrëdhënies së punës pa procedurë të rregullt punësimi.	MAP	Gjysma e dytë e vitit 2021	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
	2.1. Hartimi i një analize funksionale në subjektet e sektorit publik.	MAP Ministritë NJVL	Gjysma e dytë e vitit 2021 në kontinuitet	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E realizuar	E realizuar
	2.2. Publikimi i analizës funksionale në faqet e internetit të institucioneve.	MAP Ministritë NJVL	Gjysma e dytë e vitit 2021 në kontinuitet	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
	2.3. Analiza e nevojës për vendosjen e një vlerësimi vjetor të vëllimit të punës në subjektet e sektorit publik.	MAP	Gjysma e dytë e vitit 2021	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
3. Përcaktimi adekuat i llojit të arsimit për një vend konkret pune në aktet për sistematizimin e vendeve të punës.	3.1 Ndryshimi i “Rregullores për përmbajtjen dhe mënyrën e përgatitjes së akteve për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, si dhe përmbajtjen e analizës funksionale të institucioneve të sektorit publik”.	MAP ME MVL	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar

4. Rritja e transparencës gjatë punësimeve në sektorin publik.	4.1 Forcimi i mbikëqyrjes në lidhje me publikimin e akteve për organizim dhe sistematizim, si dhe të punësimeve, në përputhje me nenin 10 të Ligjit për Qasje të Lirë në Informacionet me Karakter Publik.	AQLI	Gjysma e parë e vitit 2021 - në kontinuitet	E perealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
Problemi 2: Menaxhim, udhëheqje dhe mbikëqyrje joefikase në disa organe të administratës, agjenci, ndërmarrje publike dhe shoqëri aksionare në pronësi shtetërore.								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Të optimizohet numri i anëtarëve në këshillat mbikëqyrës dhe bordet drejtuese në ndërmarrjet publike dhe shoqëritë aksionare.	1.1. Përcaktimi i kritereve (kompetencat, të ardhurat/shpenzimet, numri i të punësuarve) në Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare, në lidhje me optimizimin e numrit të anëtarëve në organet drejtuese.	ME MAP MVL	Gjysma e dytë e vitit 2021	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E realizuar	/
	1.2. Harmonizimi i statuteve të ndërmarrjeve publike dhe shoqërive aksionare në përputhje me ndryshimet në ligje.	Qeveria e RMV-së NJVL	Gjysma e dytë e vitit 2022	E pamaturuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
2. Vendosja e kritereve për llojin e arsimit dhe kompetencat gjatë përzgjedhjes së drejtorëve dhe emërimit të anëtarëve të këshillave drejtuese dhe mbikëqyrëse.	2.1. Ndryshime dhe plotësime në Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare në drejtum të: - përcaktimi i detyrimit ligjor që, me Statutin, të parashikohet lloji i nevojshëm i arsimit për udhëheqësit dhe anëtarët e organeve drejtuese; - përcaktimi i procedurës për emërimin në kohë të numrit të parashikuar ligjor të anëtarëve të këshillave mbikëqyrës dhe drejtuese; - përcaktimi i gjobave kundërvajtëse për themeluesin për mos emërim në kohë të anëtarëve	ME MAP	Gjysma e dytë e vitit 2021	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E perealizuar	E perealizuar	Në zhvillim e sipër

	ose për zgjedhje të paligjshme të një udhëheqësi.							
	2.2. Harmonizimi i statuteve dhe akteve të brendshme me ndryshimet në Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe Ligjin për Ndërmarrjet Publike nga organet e administratës, ndërmarrjet publike dhe shoqëritë aksionare.	Qeveria e RMV-së NJVL	Gjysma e dytë e vitit 2022	E pamaturuar	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
Problemi 3: Rregullativa ligjore nuk ka vendosur një sistem të qartë për vlerësimin e kritereve të përzgjedhjes në procesin e punësimit dhe avancimit në sektorin publik.								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Vendosja e një procesi të qartë dhe transparent të vlerësimit të kritereve për punësimet dhe avancimet në shëndetësi, arsim, kulturë, mbrojtje sociale dhe SHA-të në pronësi shtetërore.	1.1 Përcaktimi i akteve nënligjore për vendosjen e kritereve objektive dhe procesit të vlerësimit për punësim dhe avancim, në varësi të nevojave specifike të çdo sektori veç e veç.	MSH MK ME MAP MPPS MASH	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër
2. Kufizimi i të drejtës diskrete të personit përgjegjës në procesin e punësimit.	2.1. Analiza të rregullativës ligjore që mundëson të drejtën diskrete të personit përgjegjës gjatë punësimeve.	KSHPK	Gjysma e parë e vitit 2021	E realizuar	/	/	/	/
	2.2. Zbatimi i gjetjeve nga analiza e përgatitur.	MAP MSH MPPS MK ME	Gjysma e dytë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	E parealizuar

Problemi 1: Mospërputhja e një numri të madh ligjesh që rregullojnë punësimin, gjë që mundëson çdo lloj ndikimi: ndikim partiak, nepotizëm, kronizëm dhe klientelizëm.

Për realizimin e Masës 1: **Heqja e mundësisë për punësim përmes agjencive për punësime të përkohshme dhe e mundësisë që punësimet e përkohshme të transformohen në punësim me kohë të pacaktuar pa procedurë të rregullt punësimi**, është parashikuar një aktivitet, *Aktiviteti 1.1: Ndryshimi i Ligjit për të Punësuarit në Sektorin Publik me qëllim të heqjes së mundësisë për punësime përmes agjencive për punësime të përkohshme dhe për transformimin e marrëdhënies së punës pa procedurë të rregullt punësimi*. Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2021**, ndërsa institucioni përgjegjës është **MAP**. Aktiviteti për të gjitha pesë vitet me radhë është “i përealizuar”. Sipas raportit të dorëzuar nga MAP, është miratuar një Ligj i ri për të Punësuarit në Sektorin Publik (“Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr. 144/25). Nga dispozitat e ndryshuara rezulton se me ligjin e ri për punësime në sektorin publik nuk shfuqizohet mundësia për punësim përmes Agjencive për Punësime të Përkohshme. Për më tepër, edhe kufizimi fillestar i numrit të personave që gjatë vitit mund të punësohen përmes Agjencive për Punësime të Përkohshme, me ndryshimin e Ligjit për të Punësuarit në Sektorin Publik të datës 16.12.2025, është hequr. Sa i përket pjesës së dytë të aktivitetit, e cila ka të bëjë me heqjen e mundësisë për transformimin e marrëdhënies së punës pa procedurë të rregullt punësimi, në LPSP-në e ri, ndryshe nga ai i mëparshmi, nuk përcaktohet në mënyrë taksative nëse mund të ketë transformim të marrëdhënies së punës. Megjithatë, mundësia për transformimin e marrëdhënies së punës nga afat i caktuar në afat të pacaktuar është e rregulluar në dispozitat e përgjithshme për marrëdhëniet e punës, dhe për rrjedhojë, mungesa e një dispozite taksative për mundësinë e transformimit të marrëdhënies së punës pa procedurë të rregullt punësimi në LPSP-në e ri nuk nënkupton se kjo është e ndaluar ose e shfuqizuar si mundësi. Për këto arsye, aktiviteti konsiderohet i përealizuar.

Për realizimin e Masës 2: **Vlerësimi i nevojave reale për numrin e të punësuarve dhe kualifikimet e tyre profesionale në subjektet e sektorit publik**, lëndë vlerësimi në periudhën raportuese janë tre aktivitete. Afati i realizimit është **gjysma e dytë e vitit 2021 në kontinuitet**, ndërsa institucioni përgjegjës për këto aktivitete është **MAP**. *Aktiviteti 2.1: Hartimi i analizës funksionale në subjektet e sektorit publik*, për të cilin MAP njofton se Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës përgatitet mbi bazën e një analize funksionale të hartuar paraprakisht. Hartimi i analizës funksionale është i detyrueshëm gjatë dorëzimit të akteve të reja. Në dispozitat e Ligjit të LPSP-në (“Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr. 144/25 dhe 252/25) nuk ekziston një dispozitë taksative që analiza funksionale duhet t’i dorëzohet MAP-it, as para dhe as së bashku me aktet për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin. LPSP rregullon vetëm se institucionet miratojnë akt për organizimin e brendshëm dhe akt për sistematizimin e vendeve të punës, pas një analize funksionale të kryer paraprakisht. Po ashtu, në LPSP-në e ri nuk ekziston kufizim për mundësinë e ndryshimit dhe plotësimit të akteve të sistematizimit, ndërsa pikërisht ndryshimet e shpeshta të këtyre akteve janë një nga arsyet kryesore të përmendura në Problemin 1 në pjesën narrative të SK 2021–2025. Megjithatë, duke marrë parasysh formulimin e aktivitetit, ai konsiderohet “i realizuar”.

Aktiviteti 2.2: Publikimi i analizës funksionale në faqet e internetit të institucioneve dhe Aktiviteti 2.3: Analiza e nevojës për vendosjen e një vlerësimi vjetor të vëllimit të punës në subjektet e sektorit publik. Aktivitetet 2.2 dhe 2.3 janë “**të përealizuara**” për vitin e pestë radhazi. MAP njofton se për Aktivitetin 2.2 nuk ka kompetencë për të kryer kontroll mbi dokumentet e publikuara në faqet e internetit të institucioneve dhe se institucionet i publikojnë aktet e tyre për sistematizim dhe organizim të brendshëm, si dhe analizat funksionale, në faqet e tyre zyrtare. Megjithatë, duke qenë se nuk ka të dhëna të sakta dhe të verifikueshme, ky aktivitet konsiderohet i përealizuar, ndërsa nevojitet bashkëpunim më i thellë me institucionet e përfshira për zbatimin e qëndrueshëm dhe të plotë të këtij aktiviteti. Për Aktivitetin 2.3, MAP thekson se, në bazë të Ligjit për Aftësim Profesional (LAP), nuk ka kompetencë për të kryer analizë lidhur me vlerësimin vjetor të vëllimit të punës në subjektet e sektorit publik.

Megjithatë, ky arsyetim bie ndesh me indikatorin e aktivitetit, sipas të cilit ministria është institucioni përgjegjës i përcaktuar në Strategji, respektivisht se duhet të hartojë një analizë të tillë.

Për realizimin e Masës 3: Përcaktimi adekuat i llojit të arsimit për një vend konkret pune në aktet për sistematizimin e vendeve të punës, është parashikuar **Aktiviteti 3.1: Ndryshimi i “Rregullores për përmbajtjen dhe mënyrën e përgatitjes së akteve për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, si dhe përmbajtjen e analizës funksionale të institucioneve të sektorit publik”, me qëllim që lloji i arsimit të lartë të përcaktohet përmes fushave shkencore, e jo përmes fushave të ngushta shkencore, në përputhje me Klasifikimin e Fraskatit të fushave shkencore, gjatë përcaktimit të llojit të arsimit në aktet e sistematizimit.** Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e parë e vitit 2022**, institucioni përgjegjës është **MAP**, ndërsa aktiviteti konsiderohet **“i parealizuar”**. Edhe pse MAP njofton se Rregullorja për përmbajtjen dhe mënyrën e përgatitjes së akteve për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, si dhe përmbajtjen e analizës funksionale të institucioneve të sektorit publik është ndryshuar, respektivisht se aktiviteti është **“realizuar”**, pas shqyrtimit të Rregullores konstatohet se ajo nuk i përmbush udhëzimet e parashikuara në këtë aktivitet, pasi lloji i arsimit të lartë për vendin e punës nuk përcaktohet përmes fushave shkencore, por sërisht përcaktohet përmes përcaktimit të fushës shkencore–kërkimore ose të një fushe shkencore–kërkimore, me përfshirjen e një, dhe deri në tre fusha shkencore–kërkimore, të cilat korrespondojnë me përshkrimin e vendit të punës.

Për realizimin e Masës 4: Rritja e transparencës gjatë punësimeve në sektorin publik, është parashikuar Aktiviteti 4.1: **Forcimi i mbikëqyrjes në lidhje me publikimin e akteve për organizim dhe sistematizim, si dhe punësimet, në përputhje me nenin 10 të Ligjit për Qasje të Lirë në Informacionet me Karakter Publik**, për të cilin afati ka qenë gjysma e parë e vitit 2021 – në kontinuitet, ndërsa institucioni përgjegjës është **AQLI**. Në vitin 2021 aktiviteti ka qenë **“i parealizuar”**, ndërsa në vitet 2022, 2023, 2024 dhe 2025 AQLI ka ndërmarrë aktivitete dhe ka kryer monitorim të faqeve të internetit të disa institucioneve, për shkak të së cilës ky aktivitet për këtë periudhë konsiderohet **“në zhvillim e sipër”**. Edhe në këtë rast ekzistojnë pengesa që kufizojnë shqiptimin e gjobave për mos publikimin e të dhënave, dhe të njëjtat duhet të adresohen dhe të tejkalohen.

Problemi 2: Menaxhim, udhëheqje dhe mbikëqyrje joefikase në disa organe të administratës, agjenci, ndërmarrje publike dhe shoqëri aksionare në pronësi shtetërore.


Për realizimin e Masës 1: Optimizimi i numrit të anëtarëve në këshillat mbikëqyrës dhe bordet drejtuese në ndërmarrjet publike dhe shoqëritë aksionare, nga dy aktivitete të parashikuara në periudhën raportuese ka mbetur Aktiviteti 1.2: **Harmonizimi i statuteve të ndërmarrjeve publike dhe shoqërive aksionare në përputhje me ndryshimet në ligje**, për të cilin afati ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2022**, ndërsa institucioni përgjegjës është **Qeveria**. Aktiviteti konsiderohet **“në zhvillim e sipër”**, pasi 13 nga gjithsej 15 ndërmarrje publike të themeluara nga Qeveria tashmë i kanë harmonizuar statutet e tyre, ndërsa 2 ndërmarrje publike janë në procedurë të marrjes së pëlqimit nga Qeveria. Në vitin 2024 është ndryshuar edhe Ligji për Shoqëritë Tregtare, me të cilin rregullohen të drejtat, detyrimet dhe kushtet që duhet të plotësojnë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, anëtarët joekzekutivë të Bordit të Drejtorëve në shoqëritë aksionare me pronësi dominuese ose të plotë shtetërore, Bordi i Drejtorëve, si dhe anëtarët e Bordit Drejtues në shoqëritë me pronësi dominuese ose të plotë shtetërore. Shoqëritë tregtare në pronësi shtetërore ende nuk i kanë harmonizuar statutet e tyre në përputhje me ndryshimet e këtyre dispozitave ligjore.

Për realizimin e Masës 2: Vendosja e kriterëve për llojin e arsimit dhe kompetencat gjatë përzgjedhjes së drejtorëve dhe emërimit të anëtarëve të këshillave drejtuese dhe mbikëqyrëse, janë parashikuar dy aktivitete, dhe atë:

- *Aktiviteti 2.1: Ndryshime dhe plotësime në Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare në drejtim të përcaktimit të detyrimit ligjor që me Statut të parashikohet lloji i nevojshëm i arsimit për udhëheqësit dhe anëtarët e organeve drejtuese, përcaktimit të procedurës për emërimin në kohë të numrit të parashikuar ligjor të anëtarëve të këshillave mbikëqyrës dhe drejtuese, si dhe përcaktimit të gjobave kundërvajtëse për themeluesin për mos emërim në kohë të anëtarëve ose për zgjedhje të paligjshme të një udhëheqësi. Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2021**, institucioni përgjegjës është **MEP**. Aktiviteti është “**në zhvillim e sipër**”, duke pasur parasysh se ndryshimet dhe plotësimet e përmendura në Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare janë miratuar, përveç në pjesën e përcaktimit të gjobave kundërvajtëse për themeluesin për mos emërim në kohë të anëtarëve ose për zgjedhje të paligjshme të një personi udhëheqës.*
- *Aktiviteti 2.2: Harmonizimi i statuteve dhe akteve të brendshme me ndryshimet në Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare, me afat realizimi në **gjysmën e dytë të vitit 2022**, institucioni përgjegjës është **Qeveria**. Ky aktivitet konsiderohet “**në zhvillim e sipër**”. Gjegjësisht, nga 15 ndërmarrje publike, 13 i kanë harmonizuar statutet e tyre me ndryshimet në Ligjin për Ndërmarrjet Publike, ndërsa 2 janë në procedurë për marrjen e pëlqimit nga Qeveria. Sa i përket ndryshimeve në Ligjin për Shoqëritë Tregtare (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 272/2024), të cilat kanë filluar të zbatohen nga 7 janari 2025, shoqëritë tregtare në pronësi shtetërore ende nuk i kanë harmonizuar statutet e tyre.*


Problemi 3: Rregullativa ligjore nuk ka vendosur një sistem të qartë për vlerësimin e kriterëve të përzgjedhjes në procesin e punësimit dhe avancimit në sektorin publik. Për realizimin e **Masës 1: Vendosja e një procesi të qartë dhe transparent të vlerësimit të kriterëve për punësimet dhe avancimet në shëndetësi, arsim, kulturë, mbrojtje sociale dhe SHA në pronësi shtetërore**, është parashikuar Aktiviteti 1.1: Përcaktimi i akteve nënligjore për vendosjen e kriterëve objektive dhe procesit të vlerësimit për punësim dhe avancim, në varësi të nevojave specifike të çdo sektori veç e veç. Afati i realizimit është **gjysma e parë e vitit 2022**, ndërsa institucione përgjegjëse janë **ministrinë**, kurse statusi është “**në zhvillim e sipër**” nga aspekti i aktiviteteve të ndërmarra nga Ministria e Shëndetësisë. Gjegjësisht, është formuar një grup pune i cili ka përgatitur draft-ndryshime të Ligjit për mbrojtjen shëndetësore, me qëllim rritjen e transparencës gjatë punësimit të punonjësve shëndetësorë, përmes publikimit të shpalljeve publike, renditjes së kandidatëve sipas kriterëve të përcaktuara dhe heqjes së të drejtës diskrete të drejtorit gjatë përzgjedhjes së kandidatit.

Për realizimin e **Masës 2: Kufizimi i të drejtës diskrecionale të personit përgjegjës në procesin e punësimit**, në këtë periudhë raportuese ka mbetur Aktiviteti 2.2: Zbatimi i gjetjeve nga analiza e përgatitur, i cili duheste të realizohet në **gjysmën e dytë të vitit 2022** nga **MAP**, ndërsa aktualisht konsiderohet “**e përpunuar**”. Në fakt, megjithëse është përgatitur një analizë e rregullativës ligjore që mundëson të drejtën diskrecionale të personit përgjegjës gjatë punësimeve, nuk ka informacion për zbatimin e gjetjeve të të njëjtës.




Fotografia 7: Niveli i përgjithshëm i realizimit në fushën përkatëse

Nga gjithsej 13 aktivitete të parashikuara në Strategjinë për këtë fushë horizontale, tre aktivitete janë realizuar (23%), pesë janë të parealizuara (38,5%), ndërsa pesë janë në zhvillim e sipër (38,5%).



Fotografia 8: Statusi i realizimit të aktiviteteve sipas viteve



Fotografia 9: Statusi i aktiviteteve sipas institucioneve

- Për MAP janë parashikuar gjashtë aktivitete, nga të cilat një është e realizuar, ndërsa pesë janë të parealizuara.
- Qeveria ka dy aktivitete të cilat janë në zhvillim e sipër.
- AQLI ka një aktivitet i cila është në zhvillim e sipër.
- MEP ka dy aktivitete, nga të cilat një është realizuar, ndërsa tjetra është në zhvillim e sipër.
- MSH ka një aktivitet në zhvillim e sipër.
- KSHPK ka një aktivitet të realizuar në vitin 2021.

5. SEKTORI I SISTEMIT POLITIK

Përshkrimi i sektorit

Në lidhje me sektorin e sistemit politik, në Strategji janë përcaktuar gjashtë probleme prioritare:

- 1) Miratimi i një numri të madh ligjesh në procedurë të shkurtuar pa arsyetim adekuat për justifikimin e këtij lloji procedure;
- 2) Përgatitja, propozimi dhe miratimi i rregullativës pa analiza të duhura paraprake cilësore, vlerësim të ndikimeve dhe procese konsultative në funksion të mbrojtjes së interesit publik;
- 3) Mosdëshkrimi i refuzimit për dorëzimin e deklaratës së gjendjes pasurore dhe interesave nga personat që kanë një detyrim të tillë;
- 4) Interaksion i parregulluar midis lobistëve dhe përfaqësuesve të organeve të pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv, si dhe funksionarëve të pushtetit lokal;
- 5) Përfshirje e pamjaftueshme e funksionarëve të nivelit më të lartë në programe edukative në fushën e etikës dhe integritetit;
- 6) Nuk ekziston mekanizëm, as organ për monitorim efektiv të paraqitjes mediatike të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore përmes portaleve të internetit.

Për tejkalimin e këtyre problemeve, me Planin e Veprimit të Strategjisë janë parashikuar shtatë masa dhe tetë aktivitete, ndërsa për realizimin e këtyre aktiviteteve përgjegjës janë:

- 1) Kuvendi,
- 2) Qeveria,
- 3) KSHPK,
- 4) MSHIA dhe
- 5) Ministria e drejtësisë (në tekstin e mëtejshëm: MD).

Shkalla e realizimit të aktiviteteve në sektorin përkatës

Në sektorin e sistemit politik janë identifikuar gjashtë probleme prioritare, për tejkalimin e të cilave në periudhën raportuese janë parashikuar shtatë masa dhe mbeten shtatë aktivitete. Bazuar në të dhënat e marra dhe analizat e kryera, gjendja e realizimit të aktiviteteve të përcaktuara me Planin e Veprimit të Strategjisë për sektorin e sistemit politik është si vijon:

Problemi 1: Miratimi i një numri të madh ligjesh në procedurë të shkurtuar pa arsyetim adekuat për justifikimin e këtij lloji procedure								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Përcaktimi në Rregullore i një përkufizimi për kompleksitetin dhe vëllimin e propozim-ligjeve.	1.1 Ndryshimi i Rregullores së punës së Kuvendit të RMV-së.	Kuvendi i RMV-së	Gjysma e dytë e vitit 2021	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
Problemi 2: Përgatitja, propozimi dhe miratimi i rregullativës shpesh bëhet pa analiza paraprake të duhura dhe cilësore, pa vlerësim të ndikimeve dhe pa procese konsultative në funksion të mbrojtjes së interesit publik								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Rregullimi i procesit të Vlerësimit të Ndikimit të Rregullativës (VNR), në drejtim të bërjes së tij të detyrueshëm.	1.1. Miratimi i një metodologjie të re për Vlerësimin e Ndikimit të Rregullativës (VNR), me bashkimin e proceseve për vlerësimin e zbatimit të rregullativës dhe kontrollin antikorrupsion të legjislacionit.	MAP Qeveria	Gjysma e dytë e vitit 2021	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
Problemi 3: Mosndëshkimi i refuzimit për dorëzimin e deklaratës së gjendjes pasurore dhe interesave nga personat që kanë një detyrim të tillë.								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Përcaktimi i gjendjes së “refuzimit për deklarimin e gjendjes pasurore dhe interesave” nga ana e personave që kanë një detyrim të tillë ligjor.	1.1. Ndryshime në LPKKI	MD	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
2. Vendosja e masave për përcaktimin e përgjegjësisë së personave që refuzojnë të dorëzojnë deklaratën e gjendjes pasurore dhe interesave.	2.1. Ndryshime në LPKKI	MD	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
Problemi 4: Interaksion i parregulluar midis lobistëve dhe përfaqësuesve të organeve të pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv, si dhe funksionarëve të pushtetit lokal								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Vendosja e rregullave për rregullimin e ndërveprimit midis lobistëve dhe përfaqësuesve të pushtetit.	1.1. Miratimi i një ligji të ri për lobimin.	MD	Gjysma e parë e vitit 2021	E realizuar	/	/	/	/
Problemi 5: Përfshirje e pamjaftueshme e bartësve të pushtetit ekzekutiv të nivelit më të lartë në programe edukative në fushën e etikës dhe integritetit.								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025

1. Forcimi i sistemit të integritetit të bartësve të pushtetit ekzekutiv të nivelit më të lartë.	1.1. Miratimi i një programi për ngritjen e ndërgjegjësimit dhe forcimin e integritetit të bartësve të pushtetit ekzekutiv të nivelit më të lartë.	KSHPK Qeveria	Gjysma e parë e vitit 2021	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E përealizuar
	1.2. Zbatimi i programit të trajnimeve.	KSHPK	Gjysma e parë e vitit 2021 – në kontinuitet	E përealizuar	E përealizuar	Në zhvillim e sipër	E realizuar	E përealizuar
Problemi 6: Nuk ekziston mekanizëm, as organ për monitorim efektiv të paraqitjes mediatike të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore përmes portaleve të internetit								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Kompensimi për reklamim në portalet e internetit të mos jetë në barrë të Buxhetit të RMV-së.	1.1. Ndryshimi i Kodit Zgjedhor në drejtim të përjashtimit të portaleve të internetit nga kompensimi i shpenzimeve për reklamimin e pjesëmarrësve në fushatat zgjedhore, deri në miratimin e një kornize ligjore për rregullimin e tyre.	MD	Gjysma e dytë e vitit 2021	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	Në zhvillim e sipër

Problemi 1: Miratimi i një numri të madh ligjesh në procedurë të shkurtuar pa arsyetim adekuat për justifikimin e këtij lloji procedure.

Për realizimin e **Masës 1: Përcaktimi në Rregullore i një përkufizimi për kompleksitetin dhe vëllimin e propozim-ligjeve**, është parashikuar një aktivitet. *Aktiviteti 1.1: Ndryshimi i Rregullores së punës së Kuvendit të RMV-së.* Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2021**, ndërsa institucioni përgjegjës është **Kuvendi**. Në vitin 2021 dhe 2022 ky aktivitet kishte status “në zhvillim e sipër”, por duke marrë parasysh se Kuvendi në vitin 2023 miratoi një Rregullore të re të punës, me të cilën nuk është përcaktuar përkufizimi për kompleksitetin dhe vëllimin e propozim-ligjeve, ky aktivitet konsiderohet “**i parealizuar**”.

Problemi 2: Përgatitja, propozimi dhe miratimi i rregullativës shpesh bëhet pa analiza paraprake të duhura dhe cilësore, pa vlerësim të ndikimeve dhe pa procese konsultative në funksion të mbrojtjes së interesit publik.

Për realizimin e **Masës 1: Rregullimi i procesit të Vlerësimit të Ndikimit të Rregullativës (VNR), në drejtim të bërjes së tij të detyrueshëm**, është parashikuar një aktivitet. *Aktiviteti 1.1: Miratimi i një metodologjie të re për VNR, me bashkimin e proceseve për vlerësimin e zbatimit të rregullativës dhe kontrollin antikorrupsion të legjislacionit.* Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2021**, ndërsa bartës është **MSHIA (MAP)**, e cila nuk ka ndërmarrë aktivitete konkrete në drejtim të realizimit të këtij aktiviteti, dhe për këtë arsye e njëjta konsiderohet “**e parealizuar**”.

Problemi 3: Mosndëshkimi i refuzimit për dorëzimin e deklaratës së gjendjes pasurore dhe interesave nga personat që kanë një detyrim të tillë.

Për realizimin e **Masës 1: Përcaktimi i gjendjes së “refuzimit për deklarimin e gjendjes pasurore dhe interesave” nga ana e personave që kanë një detyrim të tillë ligjor**, ka një aktivitet. *Aktiviteti 1.1: Ndryshime dhe plotësime në Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave.* Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e parë e vitit 2022**, ndërsa bartës është **MD**. Ky aktivitet është “**në zhvillim e sipër**”, ndërsa MD njofton se Projektligji për ndryshime dhe plotësime në Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave është në procedurë qeveritare.

Për **Masën 2: Vendosja e masave për përcaktimin e përgjegjësisë së personave që refuzojnë të dorëzojnë deklaratën e gjendjes pasurore dhe interesave**, është parashikuar *Aktiviteti 2.1: Ndryshime dhe plotësime në Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave*, për të cilin afati i realizimit ka qenë **gjysma e parë e vitit 2022**, ndërsa bartës është **MD**. Edhe ky aktivitet është “**në zhvillim e sipër**” dhe është i përfshirë në Projektligjin e sipërpërmendur për ndryshime dhe plotësime në LPKKI.

Problemi 5: Përfshirja e pamjaftueshme e bartësve të pushtetit ekzekutiv të nivelit më të lartë në programe edukative në fushën e etikës dhe integritetit.


Për tejkalimin e këtij problemi është parashikuar një Masë. **Masa 2: Forcimi i sistemit të integritetit të bartësve të pushtetit ekzekutiv të nivelit më të lartë**, e cila në këtë periudhë raportuese përfshin dy aktivitete. *Aktiviteti 1.1: Miratimi i një programi për ngritjen e ndërgjegjësimit dhe forcimin e integritetit të bartësve të pushtetit ekzekutiv të nivelit më të lartë*, për të cilin afati ka qenë **gjysma e parë e vitit 2021**, institucioni përgjegjës është **KSHPK**, ndërsa aktiviteti konsiderohet “**i parealizuar**”. Respektivisht, në kuadër të përcaktimit strategjik për forcimin e integritetit dhe llogaridhënies në sektorin publik, KSHPK gjatë vitit 2024 identifikoi nevojën për përmirësim sistematik dhe të vazhdueshëm të përgjegjësisë politike të bartësve të pushtetit ekzekutiv të nivelit më të lartë. Kjo rrjedh nga vlerësimet se parandalimi i korrupsionit dhe menaxhimi i konfliktit të interesit nuk mund të jenë të qëndrueshme pa një vullnet politik të qartë të demonstruar dhe pa shembull personal nga maja e

pushtetit ekzekutiv. Në këtë drejtim, u iniciuan disa cikle trajnimesh, punëtori tematike dhe tryeza të rrumbullakëta me personat e emëruar sipas LPKKI-së, me fokus të veçantë të kryetarët e komunave dhe bartësit e funksioneve në vetëqeverisjen lokale (me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Shkup) dhe personat e emëruar nga pushteti qendror (me mbështetjen e projektit “Partneriteti kundër korrupsionit”, i financuar nga USAID). Këto aktivitete kishin për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për përgjegjësinë personale, menaxhimin e rreziqeve nga konflikti i interesit, transparencën në vendimarrje dhe rolin e integritetit si parakusht për besimin publik. Megjithatë, gjatë vitit 2025 nuk u sigurua kontinuitet në realizimin e këtyre aktiviteteve, kryesisht për shkak të ndryshimit të prioritetëve në kuadër të mbështetjes së donatorëve dhe përfundimit të aktiviteteve të projekteve. Bashkëpunimi me OSBE-në në këtë periudhë ka qenë i orientuar drejt punës së drejtpërdrejtë me personat për integritet në institucione, ndërsa projekti i mbështetur nga USAID u mbyll, gjë që rezultoi në ulje të mbështetjes institucionale dhe financiare për aktivitetet e drejtuara ndaj bartësve të pushtetit ekzekutiv të nivelit më të lartë. Prandaj, përvoja e vitit 2024 dhe mungesa e kontinuitetit në vitin 2025 e konfirmojnë qartë nevojën që këto aktivitete të institucionalizohen përmes miratimit formal të një programi të veçantë për ngritjen e ndërgjegjësimit dhe forcimin e integritetit të bartësve të pushtetit ekzekutiv të nivelit më të lartë, në vend të zbatimit të tyre vetëm në bazë projektsh. Vendosija e një programi të tillë do të sigurojë: një qasje sistematike në vend të aktiviteteve ad-hoc, një komponent edukativ të rregullt dhe të detyrueshëm, një lidhje të qartë me objektivat strategjike për rritjen e përgjegjësisë politike dhe një demonstrim të dukshëm të vullnetit politik në drejtim të forcimit të integritetit.

Aktiviteti 2.2: Zbatimi i programit të trajnimeve konsiderohet “i parealizuar”. Gjatë vitit 2025 nuk u zhvilluan trajnime të dedikuara ekskluzivisht për bartësit e pushtetit ekzekutiv të nivelit më të lartë, për shkak të mungesës së një programi të institucionalizuar dhe ndërprerjes së mbështetjes së projekteve, e cila në periudhën e mëparshme mundësonte organizimin e këtyre aktiviteteve. Ky fakt e thekson më tej nevojën për vendosjen e një programi formal dhe parashikimin e resurseve buxhetore dhe organizative për realizimin e tij të vazhdueshëm. Në periudhën raportuese nuk janë regjistruar funksionarë të nivelit më të lartë të pushtetit ekzekutiv të përfshirë në një program të veçantë trajnimi në fushën e integritetit dhe etikës. Përvojat e viteve të mëparshme tregojnë se interesi dhe përfshirja në aktivitete të tilla janë dukshëm më të larta kur ekziston një kornizë e qartë institucionale, mbështetje politike dhe detyrim i formalizuar për pjesëmarrje. Prandaj, në periudhën e ardhshme strategjike është e domosdoshme të vendoset një mekanizëm që siguron përfshirje sistematike dhe të matshme të funksionarëve të nivelit më të lartë.


Problemi 6: Nuk ekziston mekanizëm dhe organ për monitorim efektiv të paraqitjes mediatike të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore përmes portaleve të internetit. Për këtë problem është parashikuar një masë. **Masa 1: Kompensimi për reklamim në portalet e internetit të mos jetë në barrë të Buxhetit të RMV-së,** me një aktivitet. *Aktiviteti 1.1: Ndryshimi i Kodit Zgjedhor në drejtim të përjashtimit të portaleve të internetit nga kompensimi i shpenzimeve për reklamimin e pjesëmarrësve në fushatat zgjedhore, deri në miratimin e një kornize ligjore për rregullimin e tyre.* Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2021**, institucioni përgjegjës është **MD**, ndërsa statusi i tij është **“në zhvillim e sipër”**. MD ka njoftuar se gjatë vitit 2025 ka përgatitur ndryshime të Kodit Zgjedhor, në të cilat janë inkorporuar një pjesë e rekomandimeve të OSBE/ODIHR. Gjithashtu, në gjysmën e dytë të janarit 2026 do të formojë një grup pune për shkak të nevojës për rregullim sistematik dhe gjithëpërfshirës të Kodit Zgjedhor, në kuadër të të cilit do të shqyrtohen të gjitha çështjet aktuale dhe rekomandimet e organizatave vendore dhe ndërkombëtare, përfshirë edhe masat e parashikuara me Strategjinë.

KSHPK ka kryer verifikimin dhe kontrollin e të dhënave të marra nga institucionet kompetente dhe ka përcaktuar statusin e mëposhtëm të aktiviteteve në sektorin e sistemit politik:




Fotografia 10: Niveli i përgjithshëm i realizimit në sektorin përkatës

Nga gjithsej tetë aktivitete të parashikuara në Strategjinë për sektorin e sistemit politik, një aktivitet është i realizuar (12%), tre aktivitete janë në zhvillim e sipër (38%), ndërsa katër aktivitete janë të përealizuara (50%).



Fotografia 11: Statusi i realizimit të aktiviteteve sipas viteve



Fotografia 12: Statusi i realizimit të aktiviteteve sipas institucioneve

- Për MAP është paraparë një aktivitet, i cili është i përfunduar.
- Kuvendi i RMV-së ka një aktivitet të përfunduar.
- MD ka katër aktivitete, prej të cilave një është i realizuar, ndërsa tre janë në zhvillim e sipër.
- KSHPK ka dy aktivitete, prej të cilave të dyja janë të përfunduara.

6. SEKTORI I GJYQËSORIT

Përshkrimi i sektorit

Problemet prioritare në sektorin e drejtësisë janë:

- 1) Sistem jo mjaftueshëm efikas për forcimin e integritetit në gjyqësor dhe prokurorinë publike;
- 2) Burime të pamjaftueshme materiale dhe kadrovike, mungesë e sistemit të automatizuar për shpërndarjen dhe ndjekjen e lëndëve në prokurorinë publike dhe transparencë e pamjaftueshme në punën e Këshillit të Prokurorëve Publikë;
- 3) Efikasitet dhe transparencë e pamjaftueshme në punën e Avokaturës Shtetërore.

Institucionet përgjegjëse për realizimin e masave dhe aktiviteteve për tejkalimin e problemeve në sektorin e gjyqësorit janë:

- 4) MD
- 5) MF
- 6) Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm PPRMV)
- 7) Avokatura Shtetërore (në tekstin e mëtejshëm ASH)
- 8) Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë (në tekstin e mëtejshëm AGJPP)
- 9) Shoqata e Prokurorëve Publikë

Shkalla e realizimit të aktiviteteve në sektorin përkatës

Në sektorin e gjyqësorit janë konstatuar tre probleme, për tejkalimin e të cilave, në periudhën raportuese, kanë mbetur 5 masa dhe 8 aktivitete. KSHPK ka kryer verifikimin dhe analizën e të dhënave

të pranuar lidhur me realizimin e masave dhe aktiviteteve në sektorin e drejtësisë dhe ka përcaktuar gjendjen e mëposhtme:

Problemi 1: Sistem jo mjaftueshëm efikas për forcimin e integritetit në gjyqësor dhe prokurorinë publike								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Plotësimi i Kodit të Prokurorëve Publikë me komente dhe shembuj	1.1. Propozimi i komenteve dhe shembujve për Kodin nga Shoqata e Prokurorëve Publikë	Shoqata e Prokurorëve Publikë	Gjysma e dytë e vitit 2021	E realizuar	/	/	/	/
	1.2. Miratimi i plotësimeve të Kodit të Prokurorëve Publikë	PPRMV	Gjysma e dytë e vitit 2021	E realizuar	/	/	/	/
2. Zbatimi i trajnimeve të detyrueshme për gjyqtarët dhe prokurorët publikë me qëllim të zbatimit të kodeve për sjelljes profesionale	2.1. Miratimi i programeve për trajnime të detyrueshme mbi sjelljen profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë	AGJPP	Gjysma e dytë e vitit 2021	E realizuar	/	/	/	/
	2.2. Zbatimi i trajnimeve nga Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë	AGJPP	Gjysma e dytë e vitit 2021 në kontinuitet	E realizuar	E realizuar	E realizuar	E realizuar	E realizuar
3. Zbatimi i vlerësimit të rreziqeve të korrupsionit në sistemin e drejtësisë	3.1. Formimi i një grupi pune ekspertësh për vlerësimin e rreziqeve të korrupsionit në sistemin e drejtësisë	KSHPK	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E realizuar	/	/	/
	3.2. Hartimi i një analize të thelluar dhe vlerësimi i faktorëve që gjenerojnë korrupsion në sistemin e gjyqësorit	KSHPK	Gjysma e dytë e vitit 2022	E pamaturuar	Në zhvillim e sipër	E realizuar	/	/
Problemi 2: Resurse të pamjaftueshme materiale dhe kadrovike, mungesë e sistemit të automatizuar për shpërndarjen dhe ndjekjen e lëndëve në prokurorinë publike dhe transparencë e pamjaftueshme në punën e Këshillit të Prokurorëve Publikë								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Ekipim kadrovik të prokurorive publike në përputhje me sistematizimet ekzistuese të vendeve të punës.	1.1. Rritja e mjeteve buxhetore për Prokurorinë Publike për punësime të reja.	MF	Gjysma e dytë e vitit 2021	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E perealizuar	Në zhvillim e sipër	E perealizuar
	1.2. Zbatimi i trajnimeve për prokurorët e rinj publikë.	AGJPP	2021, Në kontinuitet	E realizuar	E realizuar	E realizuar	E realizuar	E realizuar

2. Formimi i qendrave hetimore brenda prokurorive publike.	2.1. Sigurimi i mjeteve buxhetore për qendrat hetimore.	MF	2021, Në kontinuitet	Në zhvillim e sipër	E realizuar	E parealizuar	E parealizuar	E realizuar
	2.2. Marrja e vendimit për formimin e qendrave hetimore.	PPRMV	2021, Në kontinuitet	Në zhvillim e sipër	E realizuar	E realizuar	Në zhvillim e sipër	E realizuar
3. Vendorsja e një sistemi të automatizuar për shpërndarjen dhe ndjekjen e lëndëve në prokurorinë publike.	3.1. Analizë e procesit të menaxhimit të lëndëve në Prokurorinë Publike të RMV-së.	PPRMV	Gjysma e parë e vitit 2021	E realizuar	/	/	/	/
	3.2. Prokurimi i një sistemi të automatizuar për shpërndarjen dhe ndjekjen e lëndëve.	PPRMV	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
	3.3. Trajnimi i stafit për përdorimin e tij.	PPRMV	Gjysma e dytë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
Problemi 3: Efikasiteti i pamjaftueshëm dhe transparencë e pamjaftueshme në punën e Avokaturës Shtetërore								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Rritja e efikasitetit dhe transparencës në punën e Avokaturës Shtetërore.	1.1. Miratimi i një ligji të ri për Avokaturën Shtetërore	MD	Gjysma e dytë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër

Në kuadër të **Problemit 1: Sistem joefikas për forcimin e integritetit në gjyqësor dhe prokurorinë publike**, është paraparë **Masa 2: Zbatimi i trajnimeve të detyrueshme për gjyqtarët dhe prokurorët publikë me qëllim të zbatimit të kodeve për sjelljes profesionale**, në periudhën raportuese mbetet vetëm *Aktiviteti 2.2: Zbatimi i trajnimeve nga Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë*, në kompetencë të AGJPP-së, me afat realizimi në **vitin 2021 dhe në kontinuitet**. Ky aktivitet për të pestin vit me radhë është **“i realizuar”**. Gjegjësisht, realizimi i 20 trajnimeve tematike gjatë vitit 2025, me një numër të konsiderueshëm dhe me prani të larmishme pjesëmarrësish nga sistemi i gjyqësorit, tregon një qasje aktive dhe funksionale drejt avancimit të standardeve profesionale dhe etike.

Problemi 2: Burime të pamjaftueshme materiale dhe kadrovike, mungesë e sistemit të automatizuar për shpërndarjen dhe ndjekjen e lëndëve në prokurorinë publike dhe transparencë e pamjaftueshme në punën e Këshillit të Prokurorëve Publikë.

Për tejkalimin e këtij problemi në sektorin e drejtësisë janë paraparë tre masa.

Masa 1: Ekipim kadrovik i prokurorive publike në përputhje me sistematizimet ekzistuese të vendeve të punës, ka dy aktivitete, edhe atë:

- *Aktiviteti 1.1: Rritja e mjeteve buxhetore për Prokurorinë Publike për punësime të reja*, me afat realizimi në **gjysmën e dytë të vitit 2021**, në kompetencë të MF. Aktiviteti vlerësohet si **“i parealizuar”**, edhe pse MF e ka shënuar me status “në zhvillim e sipër”. Në fakt, sipas raportit të dorëzuar, MF ka dhënë mendim negativ për Planin Vjetor të Punësimeve në PPRMV për vitin 2025 për shkak të implikimeve fiskale, ndërsa një plan i reviduar për vitin 2025 nuk është dorëzuar në MF.
- *Aktiviteti 1.2: Zbatimi i trajnimeve për prokurorët e rinj publikë*, në kompetencë të AGJPP-së, me afat realizimi në vitin **2021 – dhe në kontinuitet**. Aktiviteti vlerësohet si **“i realizuar”** për të pestin vit me radhë. Sipas raportit të dorëzuar nga AGJPP, gjatë vitit 2025 për 5 prokurorë publikë të sapoemëruar është zhvilluar një trajnim pesëditor, i cili është ndjekur nga gjithsej 29 prokurorë publikë të sapoemëruar të gjeneratës së tetë në trajnim fillestar në AGJPP.

Për **Masën 2: Formimi i qendrave hetimore në kuadër të prokurorive publike**, në periudhën raportuese kanë mbetur këto dy aktivitete:

- *Aktiviteti 2.1: Sigurimi i mjeteve buxhetore për qendrat hetimore*, e cila është në kompetencë të **MF-së** dhe e paraparë si aktivitet në **kontinuitet**. MF njofton se Prokuroria Publike e RMV-së ka rritje të buxhetit për vitin 2025 krahasuar me realizimin e vitit 2024 në vlerë rreth 131 milionë denarë. Në qarkoren buxhetore për vitin 2025 nga PPRMV nuk janë kërkuar/paraparë mjete për qendrat hetimore. Brenda buxhetit të miratuar, PPRMV i realizon aktivitetet e saj në përputhje me kompetencat e përcaktuara dhe prioritetet e definuara. Duke pasur parasysh se gjatë katër viteve të zbatimit të Strategjisë gjendja e raportimit nga MF ka qenë identike, ndërsa aktiviteti është vlerësuar si **“i parealizuar”** për shkak se PPRMV nuk ka planifikuar/kërkuar mjete buxhetore për qendrat hetimore, deri në raportin e vitit të kaluar për SK, aktiviteti është konsideruar si **“i parealizuar”**. Nëse analizohet Aktiviteti 2.2, për të cilin PPRMV raporton se gjatë vitit 2025, Prokurori Publik ka marrë vendim për formimin e 2 qendrave të reja hetimore në Manastir dhe Shtip, që del se PPRMV ka hapur qendra të reja hetimore edhe pse nuk ka kërkuar mjete buxhetore nga MF. Me këtë, numri i qendrave hetimore në prokuroritë publike është rritur në gjithsej 6. Nga data 01.08.2025 ka filluar zyrtarisht punën Qendra Hetimore në PP Manastir, në të cilën janë angazhuar 2 hetues nga MPB. Ndërsa, sa i përket Qendrës Hetimore në PP Shtip, deri në fund të vitit 2025 kanë filluar aktivitetet për ekipim, me përgatitjen e shpalljes për pranimin e dy hetuesve. Nga analiza e Aktiviteteve 2.1 dhe 2.2 rezulton se, në kuadër të buxhetit të miratuar, PPRMV i ka realizuar aktivitetet e saj në përputhje me kompetencat e përcaktuara dhe prioritetet e definuara. Aktiviteti konsiderohet **“i realizuar”**, pasi buxheti për vitin 2025 është rritur krahasuar me vitin 2024 dhe, pavarësisht se nuk janë kërkuar mjete për qendrat hetimore, gjatë vitit 2025, në kuadër të buxhetit të siguruar, janë formuar 2 qendra të reja hetimore, nga të cilat njëra ka filluar zyrtarisht punën, ndërsa për tjetrën aktivitetet për plotësim me personel janë në zhvillim e sipër.


- **Aktiviteti 2.2: Marrja e vendimit për formimin e qendrave hetimore**, e cila është në kompetencë të **PPRMV-së në kontinuitet**. Sipas raportit të dorëzuar, PPRMV gjatë vitit 2025 ka marrë vendim për formimin e dy qendrave të reja hetimore në Manastir dhe Shtip. Me këtë, numri i qendrave hetimore në prokuroritë publike është rritur në gjithsej 6. Nga data 01.08.2025 ka filluar zyrtarisht punën Qendra Hetimore në PP Manastir, ku janë angazhuar dy hetues nga MPB. Sa i përket Qendrës Hetimore në PP Shtip, në fund të vitit 2025 kanë filluar aktivitetet për pajisjen dhe funksionalizimin e saj, përmes përgatitjes së shpalljes për pranimin e dy hetuesve. Siç është theksuar edhe më lart, aktiviteti konsiderohet **“i realizuar”**.

Për Masën 3: Vendosja e një sistemi të automatizuar për shpërndarjen dhe ndjekjen e lëndëve në prokurorinë publike, në periudhën raportuese vlerësohen dy aktivitete:

- **Aktiviteti 3.2: Prokurimi i një sistemi të automatizuar për shpërndarjen dhe ndjekjen e lëndëve**, i paraparë për **gjysmën e parë të vitit 2022**, në kompetencë të **PPRMV-së**. Sipas raportit të dorëzuar, gjatë vitit 2025, përmes projektit “Mbështetje e BE-së për sundimin e ligjit”, janë siguruar mjete për një sistem të ri për menaxhimin elektronik të lëndëve dhe është realizuar tenderi për përzgjedhjen e kompanisë që do të zhvillojë zgjidhjen softuerike. Sistemi duhet të financohet me mjete IPA, me bashkëfinancim të pjesshëm shtetëror i cili nuk është siguruar. Duke pasur parasysh aktivitetet e ndërmarra deri më tani, aktiviteti konsiderohet **“në zhvillim e sipër”**.
- **Aktiviteti 3.3: Trajnimi i stafit për përdorimin e tij**, i paraparë për **gjysmën e dytë të vitit 2022**, në kompetencë të **PPRMV-së**. Aktiviteti është i lidhur me aktivitetin e mëparshëm, përkatësisht prokurimin e sistemit, i cili ende nuk është realizuar plotësisht, për shkak të kësaj ky aktivitet konsiderohet **“i parealizuar”**.


Problemi 3: Efikasitet i pamjaftueshëm dhe transparencë e pamjaftueshme në punën e Avokaturës Shtetërore, për të cilin është paraparë **Masa 1: Rritja e efikasitetit dhe transparencës në punën e Avokaturës Shtetërore, me Aktivitetin 1.1: Miratimi i një ligji të ri për Avokaturën Shtetërore**, me afat **gjysmën e dytë të vitit 2022**, në kompetencë të MD-së. Sipas raportit të dorëzuar dhe pas shqyrtimit ana e RVKE, gjatë vitit 2025 është përgatitur drafti i Propozim-Ligjit për Avokaturën Shtetërore dhe procedura për avancimin e tij është në zhvillim e sipër. Në këtë drejtim, ky aktivitet konsiderohet **“në zhvillim e sipër”**.

KSHPK, pas verifikimit dhe kontrollit të të dhënave të pranuar nga raportet e dorëzuara nga institucionet përgjegjëse, në sektorin e gjyqësorit ka përcaktuar statusin e mëposhtëm të aktiviteteve:




Fotografia 13: Shkalla e përgjithshme e realizimit në sektorin përkatës

Nga gjithsej 14 aktivitete të parashikuara në Strategjinë për sektorin e gjyqësorit, dhjetë aktivitete janë realizuar (72%), dy aktivitete nuk janë realizuar (14%), ndërsa dy aktivitete janë në zhvillim e sipër (14%).



Fotografia 14: Statusi i përgjithshëm i realizimit të aktiviteteve sipas viteve



Fotografia 15: Statusi i aktiviteteve sipas institucioneve

- Për SHPP është paraparë një aktivitet, e cila është e realizuar në vitin 2021.
- Për MD është paraparë një aktivitet e cila është në zhvillim e sipër.
- Për PPRMV janë paraparë pesë aktivitete, prej të cilave tre janë të realizuara, një është i parealizuar dhe një është në zhvillim e sipër.
- MF ka dy aktivitete, prej të cilave një është i parealizuar dhe tjetri i realizuar.
- KSHPK ka dy aktivitete të cilat janë të realizuara.
- AGJPP ka tre aktivitete të cilat janë të realizuara.

7. SEKTORI ORGANET PËR ZBATIMIN E LIGJIT

Përshkrimi i sektorit

Në lidhje me organet për zbatimin e ligjit, në Strategji janë identifikuar shtatë problemet e mëposhtme:

- 1) Kompetenca të mëdha diskrecionale të personave përgjegjës dhe mungesë transparence në punësime dhe avancime në MPB;
- 2) Sistem joefikas për përcaktimin e përgjegjësisë profesionale në organet për zbatimin e ligjit;
- 3) Kompetenca të paqarta dhe të pasakta të përcaktuara, si dhe përputhje e kompetencave të inspektorateve;
- 4) Veprim subjektiv dhe i papërshtatshëm i inspektorëve gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre;
- 5) Inspektim i pamjaftueshëm funksional në vetëqeverisjen lokale;
- 6) Udhëheqsia e institucioneve nuk i zbaton rekomandimet e revizionit të brendshëm dhe të Entit Shtetëror të Revizionit;
- 7) Ndikim i personave përgjegjës në institucionet publike në pavarësinë e revizionit të brendshëm.

Për realizimin e masave dhe aktiviteteve të parashikuara për tejkalimin e problemeve në sektorin e organeve për zbatimin e ligjit, janë përgjegjëse institucionet e mëposhtme:

- 8) Qeveria;
- 9) Ministria e Punëve të Brendshme (në tekstin e mëtejshëm: MPB);
- 10) MF;
- 11) Drejtoria e Policisë Financiare (në tekstin e mëtejshëm: DPF);
- 12) Drejtoria për Inteligjencë Financiare (në tekstin e mëtejshëm: DIF);
- 13) MD;
- 14) Drejtoria e Doganave (në tekstin e mëtejshëm: DD);
- 15) KSHPK;
- 16) Këshilli Inspektues (në tekstin e mëtejshëm: KI);
- 17) Ministrinë;
- 18) MSHIA/MAP;
- 19) Inspektorati Shtetëror Administrativ (në tekstin e mëtejshëm: ISHA) dhe
- 20) Enti Shtetëror i Revizionit (në tekstin e mëtejshëm: ESHR).

Shkalla e realizimit të aktiviteteve në sektorin përkatës

Në sektorin e organeve për zbatimin e ligjit janë konstatuar shtatë probleme, për tejkalimin e të cilave në periudhën raportuese vlerësohen 10 masa dhe 15 aktivitete. KSHPK ka kryer verifikimin dhe analizën e të dhënave të pranuar lidhur me realizimin e masave dhe aktiviteteve në sektorin e organeve për zbatimin e ligjit dhe në këtë sektor ka përcaktuar statusin e mëposhtëm të aktiviteteve:

Problemi 1: Kompetenca diskrecionale të personave përgjegjës dhe mungesë transparence në punësime dhe avancime në MPB								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Vendosija e transparencës në procedurën e punësimit dhe avancimit në MPB, përveç punësimeve që realizohen në bazë të dispozitave të veçanta të Ligjit për Punët e Brendshme	1.1 Ndryshimi i Ligjit për Punët e Brendshme	MPB	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E realizuar	/	/	/
2. Të sigurohet transparenca e akteve për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në MPB dhe publikimi i tyre në faqen e internetit të MPB-së, përveç vendeve të punës që realizohen në bazë të dispozitave të veçanta të Ligjit për Punët e Brendshme	2.1 Deklasifikimi i akteve për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në MPB	MPB	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E perealizuar	E perealizuar	E perealizuar	E perealizuar
Problemi 2: Sistem joefikas për përcaktimin e përgjegjësisë profesionale në organet për zbatimin e ligjit								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Krijimi i një njësie të veçantë organizative për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale në DPF dhe DIF	1.1 Ndryshimi i Ligjit për Policinë Financiare	DPF	Gjysma e dytë e vitit 2021	E perealizuar	E perealizuar	E perealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
	1.2 Harmonizimi i akteve për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në DPF dhe DIF	DPF DIF	Gjysma e dytë e vitit 2021	E perealizuar	Në zhvillim e sipër	E perealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
2. Avancimi i procesit të procedurave disiplinore në MPB	2.1 Harmonizimi i akteve të brendshme me “Strategjinë për avancimin dhe përmirësimin e procedurave disiplinore 2020–2022”	MPB	Gjysma e dytë e vitit 2021	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër

3. Vendosja e statusit të policisë gjyqësore për punonjësit në Sektorin për përgjegjësi profesionale në Drejtorinë Doganore (sipas nenit 46 dhe 47 të Kodit të Procedurës Penale)	3.1 Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Procedurën Penale, neni 47 paragrafi 2, në lidhje me fushëveprimin e veprave penale, përkatësisht zgjerimi i kompetencave të pjesëtarëve të policisë gjyqësore në Administratën Doganore edhe për veprat penale nga fusha e korrupsionit të kryera nga punonjësit e DD	MD	Gjysma e dytë e vitit 2021	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
	3.2 Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Drejtorin; Doganore (harmonizim me ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale). **	MF	Gjysma e dytë e vitit 2021	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
	3.3 Ndryshimi dhe plotësimi i Rregulloreve për sistematizimin dhe organizimin e Administratës Doganore (harmonizim me ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale dhe Ligjit për Drejtorin; Doganore).	DD	Gjysma e dytë e vitit 2021	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
4. Vendosja e detyrimit që zyrtarët doganorë të paraqesin deklaratë për gjendjen pasurore dhe interesat, si dhe për ndryshimet në gjendjen pasurore dhe interesat	4.1 Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, në drejtim të përcaktimit më të saktë të dispozitës nga neni 83.	MD	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
	4.2 Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Administratën Doganore (harmonizim me Ligjin e ndryshuar për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit).	DD	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E realizuar	/	/	/

Problemi 3: Kompetenca të përcaktuara në mënyrë të paqartë dhe joprecize, si dhe përputhje e kompetencave të inspektorateve								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	
1. Precizimi dhe përcaktimi i saktë i kompetencave të shërbimeve të veçanta inspektuese.	1.1 Analiza e kompetencave ligjore të shërbimeve inspektuese	KI	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
	1.2 Ndryshimi i ligjeve në të cilat, me anë të analizës, janë konstatuar kompetenca të pasakta ose mbivendosja e tyre me inspektoratet e tjera	Ministritë përkatëse	Gjysma e dytë e vitit 2022	E pamaturuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar
Problemi 4: Veprim subjektiv dhe i papërshtatshëm i inspektorëve gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Forcimi i integritetit të shërbimeve inspektuese.	1.1 Hartimi i metodologjisë për vlerësimin e rreziqeve të korrupsionit në shërbimet inspektuese.	MSHIA	Gjysma e dytë e vitit 2021	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar
	1.2 Përgatitja e një analize të rreziqeve të korrupsionit në shërbimet inspektuese.	MSHIA	Gjysma e dytë e vitit 2021	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	E realizuar	/
2. Të parashihet detyrimi që inspektorët të deklarojnë gjendjen pasurore dhe interesat pranë Këshillit Inspektues.	2.1 Ndryshim i ligjeve materiale që kanë të bëjnë me shërbimet inspektuese, me qëllim vendosjen e detyrimit për deklarimin e gjendjes pasurore dhe interesave.	MSHIA, KI, ministritë përkatëse	Gjysma e dytë e vitit 2021	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar
3. Përcaktimi i përgjegjësisë disiplinore për mosdeklarimin e	3.1 Të plotësohen ligjet materiale për shërbimet inspektuese me përcaktimin e masave	MSHIA, KI, ministritë përkatëse	Gjysma e dytë e vitit 2021	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar

gjendjes pasurore dhe interesave nga ana e inspektorëve.	disiplinore për mosparaqitjen e deklarave.							
Problemi 5: Inspektim jo mjaftueshëm funksional në vetëqeverisjen lokale								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Forcimi i shërbimeve inspektuese në NJVL me inspektorë të autorizuar.	1.1 Zbatimi i një mbikëqyrjeje të vazhdueshme inspektuese nga Inspektorati Shtetëror Administrativ në NJVL lidhur me përmbyshjen e detyrimit ligjor për punësimin e inspektorëve të autorizuar.	ISHA	2021, në kontinuitet	E realizuar	E realizuar	E realizuar	E realizuar	E realizuar
Problemi 6: Personat përgjegjës ose udhëheqës të institucioneve nuk i zbatojnë rekomandimet e propozuara nga auditimi i brendshëm dhe ESHR-së								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Të vendoset një sistem efikas për raportimin mbi (mos)zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të Entit Shtetëror të Revizionit, drejtuar organeve më të larta mbikëqyrëse dhe kontrolluese.	1.1 Ndryshim i Ligjit për kontrollin e brendshëm financiar publik.	MF	Gjysma e parë e vitit 2021	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E përealizuar	E realizuar	/
	1.2 Ndryshim i Ligjit për Revizionin Shtetëror.	MF	Gjysma e parë e vitit 2021	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E përealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
Problemi 7: Ndikimi i personave përgjegjës në institucionet publike mbi pavarësinë e auditimit të brendshëm								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Sigurimi i pavarësisë në punën e auditimit të brendshëm përmes formimit të një njësie të veçantë në Ministrinë e Financave.	1.1 Ndryshim i Ligjit për kontrollin e brendshëm financiar publik.	MF	Gjysma e parë e vitit 2023	E pamaturuar	E pamaturuar	Në zhvillim e sipër	E realizuar	/
	1.2 Ndryshim i aktit për organizimin dhe sistematizimin e Ministrisë së Financave.	MF	Gjysma e dytë e vitit 2023	E pamaturuar	E pamaturuar	Në zhvillim e sipër	E realizuar	/

Për tejkalimin e **Problemit 1: Kompetenca diskrecionale të personave përgjegjës dhe mungesë transparence në punësime dhe avancime në MPB, në periudhën raportuese mbetet Masa 2: Të sigurohet transparencia akteve për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në MPB dhe publikimi i tyre në faqen e internetit të MPB-së, përveç vendeve të punës që realizohen në bazë të dispozitave të veçanta të Ligjit për Punët e Brendshme, dhe Aktiviteti 2.1: Deklasifikimi i akteve për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në MPB.** Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e parë e vitit 2022** në kompetencë të MPB-së. Aktiviteti është vlerësuar si **“i parealizuar”**. MPB njofton se, në përputhje me Ligjin e ri për Punët e Brendshme (“Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr. 160/25), është paraparë miratimi i disa akteve nënligjore, ndër të cilat edhe aktet për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në MPB. Duke marrë parasysh aplikimin e shtyrë të ligjit dhe afatet për miratimin e akteve nënligjore, në këtë periudhë po ndërmerren aktivitete për përgatitjen e tyre. Në kuadër të këtij procesi, do të realizohet analizë, si dhe konsultim dhe koordinim me njësinë kompetente organizative për sigurinë e informacioneve të klasifikuara lidhur me nevojën, mundësinë dhe mënyrën e deklasifikimit të akteve për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës, pas së cilës do të përcaktohet qëndrimi përfundimtar për këtë çështje.

Problemi 2: Sistem joefikas për përcaktimin e përgjegjësisë profesionale në organet për zbatimin e ligjit.

Masa 1: Vendosja e një njësie të veçantë organizative për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale në DPF dhe DIF, në periudhën raportuese përfshin dy aktivitete, edhe atë:

- **Aktiviteti 1.1: Ndryshimi i Ligjit për Policinë Financiare, me afat gjysmën e dytë të vitit 2021,** ndërsa institucioni përgjegjës është **MF**. Ministria e Financave njofton se procedura lidhur me Propozim-Ligjin për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për Policinë Financiare është **“në zhvillim e sipër”**.
- **Aktiviteti 1.2: Harmonizimi i akteve për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në DPF dhe DIF.** Afati për këtë aktivitet ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2021**, ndërsa institucioni përgjegjës është **DIF**. DIF njofton se në propozim-ligjin për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për Policinë Financiare është paraparë dispozitë për vendosjen e një njësie të veçantë organizative për kontroll të brendshëm në Drejtorinë e Policisë Financiare. Propozim-ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për Policinë Financiare është dorëzuar në MF për shqyrtim dhe procedim të mëtejshëm. DIF e ka përmbushur këtë aktivitet në vitin 2022. Aktiviteti vlerësohet **“në zhvillim e sipër”**.

- 1) 1. Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (në tekstin e mëtejshëm: MMJPH) dhe
- 2) 2. NJVL (Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale).

Shkalla e realizimit të aktiviteteve në sektorin e mjedisit jetësor

Në sektorin e mjedisit jetësor është konstatuar një problem, për tejkalimin e të cilit, në Planin e Veprimit të Strategjisë, në periudhën raportuese janë paraparë një masë dhe dy aktivitete.

KSHPK ka kryer verifikimin e të dhënave dhe ka bërë analizë në lidhje me realizimin e masave dhe aktiviteteve në sektorin e mjedisit jetësor, dhe ka konstatuar gjendjen si vijon:

Problemi 1: Mosvendosja e një sistemi të integruar rajonal për menaxhimin e mbeturinave								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Themelimi i Qendrave Rajonale për Menaxhimin e Mbeturinave	1.1. Shpallja e konkursit për përzgjedhjen e koncesionarëve	MMJPH	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
	1.2. Miratimi i vendimeve për dhënien e koncesioneve për menaxhimin e mbeturinave	NJVL BNJVL	Gjysma e dytë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër

Për të vetmin **Problem 1: Mosvendosja e një sistemi të integruar rajonal për menaxhimin e mbeturinave** në sektorin e mjedisit jetësor është paraparë një masë. **Masa 1: Themelimi i Qendrave Rajonale për Menaxhimin e Mbeturinave**, e cila përfshin dy aktivitete, si vijon:

- **Aktiviteti 1.1: Shpallja e konkursit për përzgjedhjen e koncesionarëve**, për të cilin afati i realizimit ka qenë **gjysma e parë e vitit 2022**, ndërsa bartës është **MMJPH**. Ky aktivitet është zbatuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë viteve të fundit, por ende nuk është realizuar plotësisht, prandaj ka statusin “**në zhvillim e sipër**”. Në fakt, MMJPH njofton se fokusi i aktiviteteve në sektorin e menaxhimit të mbeturinave vazhdon në drejtim të krijimit të një sistemi të integruar rajonal për menaxhimin e mbeturinave, në përputhje me detyrimet e ndërmarra me kredinë nga BERZH dhe projektet IPA. Në zhvillim e sipër është realizimi i projektit për zhvillim korporativ dhe mbështetje institucionale (nga dhjetori 2024), si dhe projekti për përgatitjen e studimit të fizibilitetit për rajonin e Vardarit dhe rajonin Juglindor (nga korriku 2025), të cilat janë pjesë e projektit “Menaxhimi Rajonal i Mbeturinave”. Në kuadër të të njëjtit projekt, gjatë vitit 2025 u realizua prokurimi i pajisjeve për mirëmbajtjen e deponisë rajonale në Rusino, si dhe u realizua prokurimi i automjeteve dhe koshave e kontejnerëve për komunat e rajonit të Pelagonisë/Jugperëndimit për menaxhimin e mbeturinave. Në zhvillim e sipër është edhe dorëzimi i pajisjeve. Për rajonin lindor dhe veriperëndimor për menaxhimin e mbeturinave është realizuar një projekt për forcimin e kapaciteteve të vetëqeverisjes lokale për zbatimin e sistemit rajonal të menaxhimit të mbeturinave (projekt i financuar me mjete IPA 2). Projekti ka përfunduar në dhjetor të vitit 2025. Në zhvillim e sipër është edhe projekti për mbylljen e deponive jo standarde në rajonin lindor (i cili financohet me mjete IPA 2).
- **Aktiviteti 1.2: Miratimi i vendimeve për dhënien e koncesioneve për menaxhimin e mbeturinave**, për të cilin afati i realizimit ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2022**, ndërsa bartës janë **NJVL-të**. Ashtu si në raportin për vitin 2024, NJVL-të sërish njoftojnë se nuk janë institucioni përgjegjës për këtë aktivitet dhe referojnë në të dhënat e mediave për aktivitetet e ndërmarra në drejtim të përmbushjes së tij.

Gjegjësisht, më 10 dhjetor 2025, në organizim të SALAR International, në bashkëpunim me MMJPH, katërmëdhjetë kryetarë komunash kanë formuar Komitetin Ndërkomunal për Menaxhimin e Mbeturinave (KNMM) për rajonin jugperëndimor dhe atë të pelagonisë, bashkëpunim i cili krijohet për ushtrimin e përbashkët të kompetencave të komunave dhe realizimin e interesave dhe qëllimeve të përbashkëta. Ky Aktivitet konsiderohet “**në zhvillim e sipër**”.

13. SEKTORI I BUJQËSISË

Përshkrimi i sektorit

Në lidhje me sektorin e bujqësisë, në Strategji janë përcaktuar këto pesë probleme prioritare:

- 1) Ridefinimi i sistemit të shitjes së tokës bujqësore në pronësi shtetërore dhe vendosja e një mbikëqyrjeje efektive mbi destinimin e përdorimit të tokës dhe përmbushjen e kontratave për përdorimin e tokës bujqësore shtetërore;
- 2) Ndryshime të shpeshta të rregullativës dhe kritere jo të qarta për ndarjen e subvencioneve;
- 3) Numër i pamjaftueshëm i të punësuarve dhe edukimi i tyre, asistencë e pamjaftueshme për udhëzimin e qytetarëve, jotransparencë e procedurave;
- 4) Koncentrim i kompetencave në krijimin e politikave, zbatimin e tyre dhe mbikëqyrjen në fushën e ushqimit;
- 5) Koncentrim i kompetencave në krijimin e politikave, zbatimin e tyre dhe mbikëqyrjen në fushën e veterinarisë.

Për realizimin e masave dhe aktiviteteve të parapara për tejkalimin e problemeve në sektorin e bujqësisë, kompetente janë institucionet në vijim:

- 1) Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (në tekstin e mëtejshëm: MBPEU),
- 2) MF,
- 3) KI,
- 4) Agjencia për Ushqim dhe Veterinari (në tekstin e mëtejshëm: AUV),
- 5) Agjencia për Mbështetje Financiare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (në tekstin e mëtejshëm: AMFBZHR),
- 6) Agjencia për Nxitjen e Zhvillimit të Bujqësisë (në tekstin e mëtejshëm: ANZHB), dhe
- 7) Inspektorati Shtetëror i Bujqësisë (në tekstin e mëtejshëm: ISHB).

Shkalla e realizimit të aktiviteteve në sektorin e bujqësisë.

Në sektorin e bujqësisë janë konstatuar pesë probleme, për tejkalimin e të cilave, në Planin e Veprimit të Strategjisë, në periudhën raportuese janë paraparë 9 masa dhe 14 aktivitete.

KSHPK ka kryer verifikimin e të dhënave dhe ka bërë analizë në lidhje me realizimin e masave dhe aktiviteteve në bujqësi, dhe ka konstatuar gjendjen si vijon:

Problemi 1: Ripërcaktimi i sistemit për shitjen e tokës bujqësore në pronësi shtetërore dhe mbikëqyrje efektive mbi destinimin e përdorimit të tokës, si dhe përmbushjen e kontratave për përdorimin e tokës bujqësore shtetërore								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Forcimi i mbikëqyrjes mbi përdorimin e dedikuar të tokës dhe realizimin e kontratave të qirasë për tokën bujqësore	1.1. Përcaktimi i procedurave të detajuara për ushtrimin e mbikëqyrjes mbi përdorimin sipas destinimit dhe realizimin e kontratave për dhënien me qira të tokës bujqësore.	MBPEU	Gjysma e dytë e vitit 2021	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	E realizuar
	1.2. Ndryshimi i Ligjit për përdorimin e tokës bujqësore në drejtim të përcaktimit të sanksioneve për shkeljet e konstatuara, veçanërisht për anëtarët e komisionit, për njësinë organizative për menaxhimin e tokës bujqësore dhe për inspektorët kompetentë që kryejnë mbikëqyrje te operatorët ekonomikë që kanë tokë bujqësore nën koncesion.	MBPEU	Gjysma e dytë e vitit 2021	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar
2. Rishikimi i rregullave për shitjen e tokës bujqësore në pronësi shtetërore	2.1. Rishikimi i metodologjisë për shitjen e tokës bujqësore shtetërore në përputhje me kushtet e tregut, bazuar në klasat e tokës bujqësore.	MBPEU	Gjysma e parë e vitit 2021	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar
3. Formimi i një organi të pavarur të administratës shtetërore, i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, për shitjen e tokës bujqësore në pronësi shtetërore.	3.1. Ndryshimi i statusit juridik të komisionit për shitjen e tokës bujqësore në pronësi shtetërore në një organ të pavarur të administratës shtetërore, i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes miratimit të një ligji.	MBPEU	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar
Problemi 2: Ndryshime të shpeshta të rregullativës, kriteret jo të qarta për ndarjen e subvencioneve.								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Krijimi i masave dhe politikave të reja mbështetëse, të bazuara në parime për ruajtjen e mjedisit jetësor, futjen e praktikave të mira bujqësore dhe prodhimin e ushqimit të shëndetshëm dhe të	1.1 Përcaktimi i procedurave të qarta dhe të detajuara për mënyrën e vendosjes së masave të reja, të cilat do të mundësojnë mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe do të sjellin praktika të mira bujqësore, si dhe prodhimin e ushqimit të shëndetshëm dhe të sigurt.	MBPEU	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E përealizuar	E përealizuar	Në zhvillim e sipër	E realizuar

sigurt, si dhe përcaktimin e niveleve ekonomikisht të arsyeshme të subvencioneve.	1.2. Krijimi i çdo mase të shoqërohet me indikator suksesi, me qëllim të monitorimit të efekteve të mbështetjes financiare.	MBPEU	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E realizuar
2. Vendosja e matshmërisë së efekteve nga zbatimi i masave për mbështetje financiare në bujqësi.	2.1. Përcaktimi i një metodologjie me të cilën do të sigurohet që masat e subvencionimit të jenë në funksion të zhvillimit të bujqësisë, ndërsa shumatat e subvencioneve të jenë ekonomikisht të arsyeshme dhe të stimulojnë prodhimin real.	MBPEU	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
Problemi 3: Numër i pamjaftueshëm i të punësuarve dhe edukimi i tyre, asistencë e pamjaftueshme për orientimin e qytetarëve, jotransparencë e procedurave.								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Forcimi i kapaciteteve njerëzore të institucioneve me qëllim informimin në kohë dhe transparent të përdoruesve potencialë me informacionet relevante për qasje më të lehtë në këto mjete dhe veprim të shpejtë ndaj kërkesave.	1.1. Forcimi i burimeve njerëzore me qëllim trajtimin në kohë të kërkesave për mbështetje financiare.	MF MBPEU AMFBZHR APZHB	Gjysma e parë e vitit 2021	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E realizuar
	1.2. Vendosja e kompetencës për paraqitjen e kërkesave për pagesa direkte (subvencione) te një organ i vetëm kompetent, për një procedurë të vazhdueshme aplikimi.	MF MBPEU AMFBZHR	Gjysma e parë e vitit 2021	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
	1.3. Miratimi i një zgjidhjeje ligjore për krijimin e shërbimeve këshilluese për ofrimin e ndihmës për përdoruesit potencialë për përfitimin e mbështetjes financiare.	MBPEU AMFBZHR APZHB	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E realizuar	/
2. Rritja e transparencës së procedurave dhe informimi i përdoruesve potencialë me informacionet relevante për qasje më të lehtë në këto mjete.	2.1. Të vendosen procedura për transparencë – informimi i përdoruesve potencialë për kushtet e përfitimit të mbështetjes financiare.	MBPEU AMFBZHR APZHB	Gjysma e parë e vitit 2021	E parealizuar	E parealizuar	E realizuar	/	/
	2.2. Të realizohen trajnime për të punësuarit me qëllim përmirësimin e njohurive të tyre dhe rritjen e integritetit.	MBPEU AMFBZHR APZHB	Gjysma e dytë e vitit 2020 – në kontinuitet	E parealizuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	E parealizuar
Problemi 4: Koncentrimi i kompetencave në hartimin e politikave (ligjeve dhe akteve nënligjore), zbatimin e politikave dhe ushtrimin e mbikëqyrjes në fushën e ushqimit								

Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Ndarja e kompetencave për hartimin e politikave, zbatimin e tyre dhe mbikëqyrjen.	1.1. Ndryshimi i paketës ligjore në fushën e ushqimit në drejtim të ndarjes së kompetencave për hartimin e politikave, zbatimin e tyre, mbikëqyrjen dhe zhvillimin e procedurave për kundërvajtje në fushën e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, përmes Ligjit për sigurinë e ushqimit dhe Ligjit për sigurinë e ushqimit për kafshë.	MBPEU	Gjysma e dytë e vitit 2021	E parealizuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	E parealizuar
	1.2. Krijimi i një organi të posaçëm për shërbimin inspektues të ushqimit ose transferimi i inspektorëve në Inspektoratin Shtetëror të Bujqësisë.	MBPEU KI AUV ISHB	Gjysma e dytë e vitit 2021	E parealizuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	E parealizuar
Problemi 5: Koncentrimi i kompetencave në hartimin e politikave (ligjeve dhe aktëve nënligjore), zbatimin e politikave dhe ushtrimin e mbikëqyrjes në fushën e veterinarisë								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Ndarja e kompetencave në tre segmente: hartimi i politikave, ushtrimi i kompetencave profesionale dhe kryerja e mbikëqyrjes.	1.1. Ndryshimi i paketës ligjore në drejtim të ndarjes së kompetencave për hartimin e politikave, zbatimin e tyre, mbikëqyrjen dhe zhvillimin e procedurave për kundërvajtje në fushën e shëndetit veterinar; Ligji për shëndetin veterinar, Ligji për produktet medicinale veterinare, Ligji për nënprodukte me origjinë shtazore dhe Ligji për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve.	MBPEU	Gjysma e dytë e vitit 2021	E parealizuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	E parealizuar
	1.2. Krijimi i një organi të posaçëm për shërbimin inspektues të shëndetit veterinar, duke e ndarë atë nga organi që zbaton politikën në fushën e shëndetit veterinar në një inspektorat të veçantë, ose transferimi i inspektorëve në Inspektoratin Shtetëror të Bujqësisë.	MBPEU	Gjysma e dytë e vitit 2021	E parealizuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	E parealizuar

Problemi 1: Ridefinimi i sistemit të shitjes së tokës bujqësore në pronësi shtetërore dhe vendosja e një mbikëqyrjeje efektive mbi destinimin e përdorimit të tokës dhe përmbushjen e kontratave për përdorimin e tokës bujqësore shtetërore përmban tre masa me katër aktivitete.

Masa 1: Forcimi i mbikëqyrjes mbi përdorimin e dedikuar të tokës dhe realizimin e kontratave për qiradhënien e tokës bujqësore, përfshin këto aktivitete:

- *Aktiviteti 1.1: Përcaktimi i procedurave të detajuara për ushtrimin e mbikëqyrjes mbi përdorimin e dedikuar dhe realizimin e kontratave për qiradhënien e tokës bujqësore,* për të cilin afati i realizimit ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2021**, ndërsa është në kompetencë të MBPEU-së. Ndryshe nga vitet e mëparshme, kur ky aktivitet ka qenë i parealizuar, në vitin 2025 MBPEU njofton se është **“realizuar”**. Konkretisht, në faqen e internetit të MBPJU-së është publikuar një listë kontrolli (<https://diz.gov.mk/dokumenti/obrazci-tarifnici/>), e cila është përgatitur për nevojat e Inspektoratit Shtetëror të Bujqësisë dhe përdoret gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes ndaj shfrytëzuesve të tokës bujqësore në pronësi shtetërore.
- *Aktiviteti 1.2: Ndryshimi i Ligjit për përdorimin e tokës bujqësore në drejtim të përcaktimit të sanksioneve për shkeljet e konstatuara, veçanërisht për anëtarët e komisionit, njësinë organizative për menaxhimin e tokës bujqësore dhe inspektorët kompetentë që kryejnë mbikëqyrje te operatorët ekonomikë që kanë tokë bujqësore me koncesion.* Afati i realizimit të këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2021**, ndërsa është në kompetencë të MBPEU-së. Ashtu si në vitet e mëparshme, ky aktivitet mbetet **“i parealizuar”**. MBPEU njofton se ende nuk janë paraparë sanksione për anëtarët e Komisionit apo sektorin për menaxhimin e tokës bujqësore.

Masa 2: Rishikimi i rregullave për shitjen e tokës bujqësore në pronësi shtetërore përfshin një aktivitet: *Aktiviteti 2.1: Rishikimi i metodologjisë për shitjen e tokës bujqësore shtetërore në përputhje me kushtet e tregut, bazuar në klasat e tokës bujqësore.* Këtë aktivitet, MBPEU si institucion përgjegjës, duhej ta realizonte në **gjysmën e parë të vitit 2021**. Ashtu si në vitet e mëparshme, ky aktivitet mbetet **“i parealizuar”**, pasi nuk janë bërë ndryshime në Ligjin për shitjen e tokës bujqësore në pronësi shtetërore.

Masa 3: Formimi i një organi të pavarur të administratës shtetërore, i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut për shitjen e tokës bujqësore në pronësi shtetërore, përfshin një aktivitet: *Aktiviteti 3.1: Ndryshimi i statusit juridik të Komisionit për shitjen e tokës bujqësore në pronësi shtetërore në një organ të pavarur të administratës shtetërore, të themeluar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes miratimit të një ligji,* për të cilin afati i realizimit ka qenë **gjysma e parë e vitit 2022**, ndërsa institucion përgjegjës është MBPEU. Ashtu si në vitet e mëparshme, ky aktivitet mbetet **“i parealizuar”**, pasi nuk është bërë ndryshim i statusit juridik të Komisionit për shitjen e tokës bujqësore në pronësi shtetërore.

Problemi 2: Ndryshimet e shpeshta të rregullativës dhe kriteret e pasakta për ndarjen e subvencioneve përmban dy masa me tre aktivitete.

Për Masën 1: Krijimi i masave dhe politikave të reja për mbështetje, të bazuara në parimet e ruajtjes së mjedisit, vendosjes së praktikave të mira bujqësore dhe prodhimit të ushqimit të shëndetshëm dhe të sigurt, si dhe në vlera ekonomikisht të arsyeshme të subvencioneve, janë paraparë dy aktivitete:

- *Aktiviteti 1.1: Përcaktimi i procedurave të qarta dhe të detajuara për mënyrën e futjes së masave të reja, të cilat do të mundësojnë mbrojtjen e mjedisit, zbatimin e praktikave të mira bujqësore dhe prodhimit të ushqimit të shëndetshëm dhe të sigurt.* Afati i realizimit të këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e parë e vitit 2022**, ndërsa është në kompetencë të MBPEU-së. Ndryshe nga vitet e mëparshme, në vitin 2025 ky aktivitet është **“realizuar”**. Sipas raportit të

dorëzuar, MBPEU ka miratuar Strategjinë Kombëtare për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural për periudhën e viteve 2021–2027 (<https://faolex.fao.org/docs/pdf/mac209144.pdf>), në të cilën, në Pjesën II “Qëllimet, llojet e ndërhyrjeve të politikave dhe masat për periudhën 2021–2027”, përfshihen edhe II.5.6 “Politikat për menaxhimin e burimeve natyrore dhe zbutjen e ndikimit të ndryshimeve klimatike”.

- *Aktiviteti 1.2: Krijimi i çdo mase duhet të shoqërohet me një indikator suksesi për monitorimin e efekteve të mbështetjes financiare.* Afati i realizimit të këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e parë e vitit 2022**, ndërsa i njëjti është në kompetencë të MBPEU-së. Në vitin 2025 ky aktivitet është “realizuar” me miratimin e Strategjisë Kombëtare për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural për periudhën 2021–2027, në të cilën janë parashikuar indikatorë suksesi për ndjekjen e efekteve të mbështetjes financiare.

Për Masën 2: Vendosja e matshmërisë së efekteve nga zbatimi i masave për mbështetje financiare në bujqësi është paraparë një aktivitet: *Aktiviteti 2.1: Përcaktimi i metodologjisë me të cilën do të sigurohet që masat e subvencionimit të jenë në funksion të zhvillimit të bujqësisë, ndërsa shumat e subvencioneve të jenë ekonomisht të arsyeshme dhe të stimulojnë prodhimin real.* Afati i realizimit të këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e parë e vitit 2022**, ndërsa e njëjta është në kompetencë të MBPEU-së. Edhe pse MBPEU njofton se aktiviteti është i realizuar, nga raporti i dorëzuar shihet qartë se nuk është përcaktuar metodologjia përkatëse, prandaj ky aktivitet konsiderohet “**i parealizuar**”.

Problemi 3: Numër i pamjaftueshëm i të punësuarve dhe edukimi i tyre, asistencë e pamjaftueshme për orientimin e qytetarëve, si dhe jotransparencë e procedurave përmban dy masa me pesë aktivitete.

Masa 1: Forcimi i kapaciteteve njerëzore të institucioneve me qëllim informimin në kohë dhe në mënyrë transparente të përdoruesve potencialë me informacione relevante për qasje më të lehtë në këto mjete dhe trajtim në kohë të kërkesave, përfshin këto aktivitete:

- *Aktiviteti 1.1: Forcimi i resurseve njerëzore për trajtimin në kohë të kërkesave për mbështetje financiare.* Afati i realizimit të këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e parë e vitit 2021**, dhe e njëjta është në kompetencë të MF. Ndryshe nga vitet e mëparshme, në vitin 2025 ky aktivitet është “**realizuar**”. Numri i përgjithshëm i të punësuarve në AMFBZHR në tetor 2025 ka qenë 236 persona dhe, në krahasim me dhjetorin 2024, është rritur për 17 persona.
- *Aktiviteti 1.2: Vendosja e kompetencës për paraqitjen e kërkesave për pagesa direkte (subvencione) te një organ i vetëm kompetent për një procedurë të vazhdueshme aplikimi.* Afati i realizimit të këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e parë e vitit 2021**, dhe e njëjta është në kompetencë të MF. Ky aktivitet, si në vitet e mëparshme, mbetet “**i parealizuar**”. Në fakt, MF njofton se deri në vitin 2025 nuk është dorëzuar kërkesë për marrjen e punonjësve nga MBPEU në AZHFRR. Nga raportet e viteve të mëparshme rezulton se deri më tani nuk janë transferuar punonjës nga MBPJU në AMFBZHR.

Masa 2: Rritja e transparencës së procedurave dhe informimi i përdoruesve potencialë me informacione relevante për qasje më të lehtë në këto mjete përfshin dy aktivitete, prej të cilave lëndë vlerësimi në këtë periudhë janë:


- *Aktiviteti 2.2: Realizimi i trajnimeve për punonjësit me qëllim përmirësimin e njohurive të tyre dhe rritjen e integritetit.* Afati i realizimit të këtij aktiviteti ka qenë **viti 2021 – në kontinuitet**, ndërsa institucioni përgjegjës është MBPEU. Ky aktivitet mbetet “**i parealizuar**”, ashtu si edhe më parë, pasi në Planin e trajnimeve të MBPEU-së nuk janë paraparë trajnime të specializuara për përmirësimin e njohurive në fushën e integritetit.

Për tejkalimin e **Problemit 4: Koncentrimi i kompetencave në hartimin e politikave (ligjeve dhe akteve nënligjore), zbatimin e politikave dhe ushtrimin e mbikëqyrjes në fushën e ushqimit**, në Planin e Veprimit të Strategjisë është paraparë **Masa 1: Ndarja e kompetencave për hartimin e politikave, zbatimin e tyre dhe mbikëqyrjen**, për të cilën janë paraparë Aktiviteti 1.1 dhe Aktiviteti 1.2. *Aktiviteti 1.1: Ndryshimi i paketës ligjore në fushën e ushqimit në drejtim të ndarjes së kompetencave për hartimin e politikave, zbatimin e tyre, mbikëqyrjen dhe zhvillimin e procedurave*

kundërvajtëse në fushën e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, përmes Ligjit për sigurinë e ushqimit dhe Ligjit për sigurinë e ushqimit për kafshë. Aktiviteti 1.2: Themelimi i një organi të veçantë për shërbimin inspektues të ushqimit ose transferimi i inspektorëve në Inspektoratin Shtetëror të Bujqësisë. Afati i realizimit të të dy aktiviteteve ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2021**, ndërsa bartës është MBPEU. Edhe pse këto aktivitete formalisht figurojnë si “**të parealizuar**”, me ndryshimet dhe plotësimet e Strategjisë të miratuara nga KSHPK në vitin 2023 dhe të dorëzuara në Kuvendin e RMV-së, problemi 4 në sektorin e bujqësisë është hequr, ndërsa aktivitetet e lidhura me të janë vlerësuar si pa nevojshme.


Problemi 5: Përqendrimi i kompetencave në hartimin e politikave (ligjeve dhe akteve nënligjore), zbatimin e politikave dhe ushtrimin e mbikëqyrjes në fushën e veterinarisë në sektorin e bujqësisë përmban gjithashtu një masë. Masa 1: Ndarja e kompetencave në tre segmente – hartimi i politikave, ushtrimi i kompetencave profesionale dhe ushtrimi i mbikëqyrjes e cila përfshin dy aktivitete:

- Aktiviteti 1.1: Ndryshimi i paketës ligjore në drejtim të ndarjes së kompetencave për hartimin e politikave, zbatimin e tyre, mbikëqyrjen dhe zhvillimin e procedurave kundërvajtëse në fushën e shëndetit veterinar; Ligji për shëndetin veterinar, Ligji për produktet mjekësore veterinarë, Ligji për nënproduktet me origjinë shtazore, Ligji për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve. Aktiviteti 1.2: Themelimi i një organi të veçantë për shërbimin inspektues të shëndetit veterinar, ndarë nga organi që zbaton politikën në shëndetin veterinar, në një inspektorat të veçantë ose transferimi i inspektorëve në Inspektoratin Shtetëror të Bujqësisë. Afati për të dy aktivitetet ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2021**, ndërsa bartës është **MBPEU**. Edhe pse këto aktivitete formalisht figurojnë si “**të parealizuar**”, me ndryshimet dhe plotësimet e Strategjisë të miratuara nga KSHPK në vitin 2023 dhe të dorëzuara në Kuvendin e RMV-së, problemi 5 në sektorin e bujqësisë është hequr, ndërsa aktivitetet e lidhura me të janë vlerësuar si pa nevojshëm.




Fotografia 27: Shkalla e përgjithshme e realizimit në sektorin përkatës

Nga gjithsej 16 aktivitete të parashikuara në Strategjinë për sektorin e bujqësisë, 6 janë realizuar (37%), ndërsa 10 aktivitete janë të parealizuar (63%). Në këtë sektor nuk ka aktivitete “në zhvillim e sipër”.



Fotografia 28: Statusi i aktiviteteve sipas periudhës së vlerësimit



Fotografia 29: Statusi i përgjithshëm i aktiviteteve sipas institucioneve

- Për MBPEU janë paraparë 14 aktivitete, nga të cilat 9 janë të porealizuara, ndërsa 5 janë të realizuara. Për MF janë paraparë dy aktivitete, nga të cilat një është i realizuar dhe një i porealizuar.

14. SEKTORI I SPORTIT

Përshkrimi i sektorit.

Në lidhje me sektorin e sportit, në Strategji janë përcaktuar këto dy probleme prioritare:

- 1) 1. Probleme në menaxhimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e objekteve sportive në pronësi të RMV-së dhe objekteve sportive në pronësi të NJVL-ve;
- 2) 2. Mungesë e mbikëqyrjes inspektuese në sport.

Për realizimin e masave dhe aktiviteteve të parashikuara për tejkalimin e problemeve në sektorin e sportit, kompetente janë institucionet në vijim:

- | |
|---|
| <ol style="list-style-type: none">1) Agjencia për Rini dhe Sport (në tekstin e mëtejshëm: ARS),2) Qeveria,3) MD,4) KSHPK dhe5) NJVL |
|---|

Shkalla e realizimit të aktiviteteve.

Në sektorin e sportit janë konstatuar dy probleme, për tejkalimin e të cilave, në Planin e Veprimit të Strategjisë, në periudhën raportuese janë paraparë 6 masa dhe 14 aktivitete.

KSHPK ka kryer verifikimin dhe analizën e të dhënave në lidhje me realizimin e masave dhe aktiviteteve në sektorin e sportit dhe ka konstatuar gjendjen si vijon:

flora

Problemi 1: Menaxhim, shfrytëzim dhe mirëmbajtje e papërshtatshme e objekteve sportive në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të njësive të vetëqeverisjes lokale								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Miratimi i një strategjie për objektet sportive në pronësi shtetërore	1.1. Analiza e gjendjes së objekteve sportive në pronësi shtetërore	ARS Qeveria	Gjysma e dytë e vitit 2021	E përealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E përealizuar	E përealizuar
	1.2 Regjistrimi i objekteve sportive në pronësi shtetërore	ARS NJVL	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E përealizuar	E përealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
	1.3. Përgatitja e një strategjie për objektet sportive në pronësi shtetërore, e bazuar në analizën dhe inventarizimin, veçanërisht në aspekt të: kategorizimit, pronësisë, menaxhimit, disponimit, shfrytëzimit dhe decentralizimit.	ARS	Gjysma e dytë e vitit 2022	E pamaturuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar
2. Rregullimi i statusit juridik të objekteve sportive në pronësi shtetërore	2.1. Analiza e kontratave për shfrytëzimin e objekteve sportive në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të njësive të vetëqeverisjes lokale (arsyeshmëria juridike dhe ekonomike, afatet, respektimi)	ARS NJVL	Gjysma e dytë e vitit 2021	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
	2.2. Marrja e mjeteve juridike për rregullimin e statusit juridik të objekteve sportive në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të njësive të vetëqeverisjes lokale	ARS NJVL	Gjysma e dytë e vitit 2022 – në kontinuitet	E pamaturuar	E përealizuar	E përealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
	2.3. Zbatimi i mbikëqyrjes inspektuese në lidhje me shfrytëzimin e objekteve sportive në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe	ARS NJVL	2021, në kontinuitet	E përealizuar	E përealizuar	Në zhvillim e sipër	E përealizuar	E realizuar

	të njësive të vetëqeverisjes lokale							
3.Rregullimi ligjor i objekteve sportive	3.1. Miratimi i një ligji për objektet e sportit	MD	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
	3.2. Miratimi i akteve nënligjore për: - Kategorizimin e objekteve - Rregulloren për përcaktimin e tarifës për shfrytëzimin e objekteve sportive	MD	Gjysma e dytë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
4. Vendosja e një sistemi informativ për evidencën e objekteve sportive në pronësi shtetërore	4.1. Krijimi i një baze të të dhënave për objektet sportive në pronësi shtetërore (vendndodhja, kategoria, komuna, pronësia, sipërfaqja, viti i ndërtimit, përmbajtjet, struktura, etj.)	ARS	Gjysma e parë e vitit 2023	E pamaturuar	E pamaturuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
Problemi 2: Mungesë e mbikëqyrjes inspektuese në sport								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Vendosja e një mbikëqyrjeje inspektuese të pavarur në sport dhe në objektet sportive	1.1. Analiza e gjendjes aktuale të mbikëqyrjes inspektuese në sektorin e sportit dhe në objektet sportive	ARS	Gjysma e parë e vitit 2021	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E realizuar	/
	1.2. Ndryshime dhe plotësime të Ligjit për sportin në pjesën për mbikëqyrjen inspektuese	MD	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
	1.3 Themelimi i Inspektoratit Shtetëror të Sportit	MD	Gjysma e dytë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
2. Edukimi për integritet dhe etikë të federatave sportive, klubeve dhe administratës	2.1. Miratimi i një programi për trajnime dhe edukim për integritet dhe etikë për federatat sportive, klubet, administratën dhe punonjësit sportivë.	ARS NJVL	Gjysma e parë e vitit 2021	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
	2.2. Zbatimi i trajnimeve, punësorive, tryezave të rrumbullakëta dhe paraqitjeve publike në media për integritet dhe etikë.	ARS KSHPK	Në kontinuitet	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	E parealizuar

	2.3. Hartimi i materialit propagandues për integritet dhe etikë në sport	ARS KSHPK	Në kontinuitet	E perealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E perealizuar	E perealizuar
--	--	--------------	----------------	----------------------	---------------------	---------------------	----------------------	----------------------

Problemi 1: Menaxhim, shfrytëzim dhe mirëmbajtje e papërshtatshme e objekteve sportive në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të njësive të vetëqeverisjes lokale përmban 4 masa dhe 9 aktivitete.

Masa 1: Miratimi i strategjisë për objektet sportive në pronësi shtetërore, për të cilën janë paraparë aktivitetet në vijim:

- *Aktiviteti 1.1: Analiza e gjendjes lidhur me objektet sportive në pronësi shtetërore.* Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2021**, ndërsa i njëjti është në kompetencë të ARS-së (MS). Ky aktivitet është **“i parealizuar”**, si edhe deri më tani, pasi aktualisht MS njofton se nuk disponon me numër të mjaftueshëm të resurseve njerëzore në sektorin e objekteve sportive.
- *Aktiviteti 1.2: Regjistrimi i objekteve për sport në pronësi shtetërore.* Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e parë e vitit 2022**, ndërsa i njëjti është në kompetencë të ARS (MS). Aktiviteti është **“në zhvillim e sipër”**. MS thekson se në regjistrimin ekzistues janë të regjistruara 1366 objekte për sport në RMV, 90% e komunave kanë dorëzuar të dhëna për objektet ekzistuese sportive në territorin e tyre, ndërsa 10% e mbetura edhe përkundër kërkesës së dorëzuar nga organi kompetent nuk kanë dorëzuar të dhëna. Është formuar Komision nga ana e ministrit për sport për realizimin e aktiviteteve përkatëse.
- *Aktiviteti 1.3: Hartimi i Strategjisë për objektet për sport në pronësi shtetërore i bazuar në analizën dhe regjistrimin, veçanërisht në aspekt të kategorizimit, pronësisë, menaxhimit, disponimit, shfrytëzimit dhe decentralizimit.* Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2022**, ndërsa i njëjti është në kompetencë të ARS (MS). Ky aktivitet mbetet **“i parealizuar”** si edhe deri më tani.

Masa 2: Rregullimi i statusit juridik të objekteve për sport në pronësi shtetërore i përfshin aktivitetet në vijim:

- *Aktiviteti 2.1: Analiza e kontratave për shfrytëzimin e objekteve për sport në pronësi të RMV-së dhe NJVL-të (arsyetime juridik dhe ekonomik, afatet, respektimi).* Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2021**, ndërsa i njëjti është në kompetencë të ARS (MS). MS njofton se është formuar Komision nga ana e ministrit për sport në lidhje me kompetencat e Ndërmarrjes Publike për menaxhim me objekte për sport në pronësi shtetërore dhe objektet që janë nën kompetencën e saj. Aktiviteti vlerësohet me statusin **“në zhvillim e sipër”**.
- *Aktiviteti 2.2: Ndërmarrja e mjeteve juridike për rregullimin e statusit juridik të objekteve për sport në pronësi të RMV-së dhe NJVL-të.* Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e parë e vitit 2022 – në kontinuitet**, ndërsa i njëjti është në kompetencë të ARS (MS). Ky aktivitet është **“në zhvillim e sipër”** pasi MS informon se është formuar grup pune i cili ka obligim të hartojë plan aksional për rregullimin e statusit juridik të objekteve për sport në pronësi të RMV-së dhe NJVL-të.
- *Aktiviteti 2.3: Kryerja e mbikëqyrjes inspektuese lidhur me përdorimin e objekteve për sport në pronësi të RMV dhe NJVL-të.* Ky aktivitet duhet të realizohet nga viti **2021 – në kontinuitet**, ndërsa i njëjti është në kompetencë të ARS (MS). Per dallim nga vitet e mëparshme, MS informon se aktiviteti është **“i realizuar”** në këtë cikël vlerësimi, pasi në vitin 2025 është kryer mbikëqyrje inspektuese e jashtëzakonshme në qendrën e skijimit “Kodra e Diellit”, për të cilën është përgatitur procesverbal Li.nr.14-188/4 i datës 24.02.2025.

Masa 3: Rregullimi ligjor i objekteve për sport përfshin Aktivitetin 3.1: Miratimi i Ligjit për objektet për sport dhe Aktiviteti 3.2: Miratimi i akteve nënligjore për kategorizimin e objekteve dhe Rregulloren për përcaktimin e kompensimit për përdorimin e objekteve për sport. Afati për realizimin e të dy aktiviteteve ka qenë viti 2022, institucioni përgjegjës në periudhat e mëparshme raportuese ka qenë **MD**, ndërsa nga viti 2024, institucioni përgjegjës është **MS**. Të dy aktivitetet janë **“të parealizuar”**

pasi, sipas raportit të MS, aktualisht po punohet në hartimin e një Ligji të ri për sportin, ndërsa miratimi i akteve nënligjore kushtëzohet nga miratimi i atij ligji.

Masa 4: Vendosja e një sistemi informativ për evidencën e objekteve për sport në pronësi shtetërore përmban një aktivitet. *Aktiviteti 4.1: Përgatitja e një baze të të dhënave për objektet për sport në pronësi shtetërore (vendndodhja, kategoria, komuna, pronësia, sipërfaqja, viti i ndërtimit, përmbajtjet, struktura etj.).* Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e parë e vitit 2023**, ndërsa i njëjti është në kompetencë të ARS (MS). Ky aktivitet është **“në zhvillim e sipër”** pasi MS informon se është përgatitur një bazë të dhënash për objektet për sport në pronësi shtetërore, e cila duhet të përditësohet me të dhëna nga komunat që nuk kanë dorëzuar të dhëna për objektet sportive.

Problemi 2: Mungesa e mbikëqyrjes inspektuese në sport përfshin dy masa dhe 6 aktivitete.

Masa 1: Krijimi i një mbikëqyrjeje të pavarur inspektuese në sport dhe në objektet sportive përfshin tre aktivitete, nga të cilat i pari ka qenë **“i realizuar”** në vitin 2024.


Aktiviteti 1.2: Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për sportin në pjesën për mbikëqyrjen inspektuese. Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë gjysma e parë e vitit 2022, ndërsa institucioni përgjegjës për të në periudhat e mëparshme raportuese ka qenë **MD**, ndërsa nga viti 2024 institucioni përgjegjës është MS. Sipas raportit të **MS**, në vijim është procedura e ndryshimit të Ligjit për sportin, por duke qenë se nuk janë ndërmarrë aktivitete në vitin 2025, aktiviteti konsiderohet **“i porealizuar”**.

- *Aktiviteti 1.2: Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për sportin në pjesën për mbikëqyrjen inspektuese.* Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e parë e vitit 2022**, ndërsa institucioni përgjegjës për të në periudhat e mëparshme raportuese ka qenë MD, ndërsa nga viti 2024 institucioni përgjegjës është **MS**. Sipas raportit të MS, procedura e ndryshimit të Ligjit për sport është **“në zhvillim e sipër”**, por duke qenë se nuk janë ndërmarrë aktivitete në vitin 2025, aktiviteti konsiderohet **“i porealizuar”**.
- *Aktiviteti 1.3: Krijimi i Inspektoratit Shtetëror për Sport.* Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2022**, institucioni përgjegjës në periudhat e mëparshme raportuese ka qenë **MD**, ndërsa nga viti 2024 kompetent është **MS**. Sipas raportit të MS, kjo çështje do të rregullohet me ndryshimet e Ligjit për sport dhe Ligjit për inspektim, por për momentin aktiviteti mbetet **“i porealizuar”**.

Masa 2: Edukimi për integritet dhe etikë të federatave sportive, klubeve dhe administratës përmban tre aktivitete:


- *Aktiviteti 2.1: Miratimi i programit për trajnime dhe edukim për integritet dhe etikë të federatave sportive, klubeve, administratës dhe punonjësve sportivë.* Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e parë e vitit 2021**, ndërsa institucioni përgjegjës është **ARS (MS)**. Institucioni vlerëson se ky aktivitet është **“në zhvillim e sipër”**. Megjithatë, duke pasur parasysh faktin se treguesi i aktivitetit është **“program i miratuar për trajnime dhe edukim”**, dhe për të pestin vit radhazi raportohet se një program i tillë është në përgatitje, i njëjti konsiderohet **“i porealizuar”**.
- *Aktiviteti 2.2: Zbatimi i trajnimeve, punëtorive, tryezave të rrumbullakëta dhe paraqitjeve publike mediatike për integritet dhe etikë.* Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e parë e vitit 2021**, ndërsa institucioni përgjegjës është **ARS (MS)**. Sipas raportit të dorëzuar për vitin 2025, MS njofton se aktiviteti zbatohet në kontinuitet. Megjithatë, i njëjti konsiderohet **“i porealizuar”**, pasi nuk është miratuar programi për trajnime dhe edukim.

- Aktiviteti 2.3: Përgatitja e materialeve propaganduese për integritet dhe etikë në sport. Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e parë e vitit 2021**, ndërsa institucioni përgjegjës është **ARS (MS)**, dhe i njëjti është **“i parealizuar”**.



Fotografia 30: Shkalla e përgjithshme e realizimit në sektorin përkatës

Nga gjithsej 15 aktivitete të parashikuara në Strategjinë për sektorin e sportit, 9 aktivitete nuk janë realizuar (60%), 4 aktivitete janë “në zhvillim e sipër” (26,7%), ndërsa vetëm dy aktivitete janë realizuar (13,3%).



Fotografia 31: Statusi i aktiviteteve sipas periudhës së vlerësimit

Nga viti 2024, për të gjitha aktivitetet në sektorin e sportit, institucioni përgjegjës është MS.

15. SEKTORI I EKONOMISË DHE BIZNESIT

Përshkrimi i sektorit

Sa i përket sektorit të ekonomisë dhe biznesit, në Strategji janë përcaktuar katër probleme prioritare si vijon:

- 1) Mungesa e një regjistri për ndihmën e dhënë shtetërore për operatorët ekonomikë në pronësi të personave juridikë vendorë dhe të huaj;
- 2) Dhënie e tepruar e koncesioneve, transparencë e pamjaftueshme e kontratave koncesionare dhe mekanizma të pamjaftueshëm të zhvilluar për përcaktimin e tarifës reale të koncesionit për lëndët e para të aksplatuara;
- 3) Mungesa e regjistrave të pasurisë në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe NJVL-të;
- 4) Përfshirje e pamjaftueshme e subjekteve më të vogla ekonomike në procesin e krijimit të politikave ekonomike dhe politikave të tjera relevante për komunitetin e biznesit.

Për realizimin e masave dhe aktiviteteve të parashikuara për tejkalimin e problemeve në sektorin e ekonomisë dhe biznesit, përgjegjëse janë institucionet në vijim:

- 1) Qeveria,
- 2) ME,
- 3) MMPH,
- 4) MBPEU,
- 5) MSH,
- 6) MSHIA,
- 7) MPB,
- 8) Agjencia për Kadastër të Patundshmërive (në vijim: AKP),
- 9) Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në vijim: KMK),
- 10) Agjencia për Mbështetjen e Sipërmarrësisë (në vijim: AMS),
- 11) Shoqëria civile dhe
- 12) Komuniteti i biznesit.

Shkalla e realizimit të aktiviteteve

Në sektorin e ekonomisë dhe biznesit janë konstatuar katër probleme, për tejkalimin e të cilave, me Planin e Veprimit të Strategjisë në periudhën raportuese janë parashikuar 8 masa dhe 13 aktivitete.

KSHPK ka kryer verifikim dhe analizë të të dhënave lidhur me realizimin e masave dhe aktiviteteve në sektorin e ekonomisë dhe biznesit dhe ka konstatuar gjendjen e mëposhtme:

Problemi 1: Mungesa e një regjistri të ndihmës shtetërore të dhënë për operatorët ekonomikë në pronësi të personave juridikë vendas dhe të huaj								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Krijimi, publikimi dhe përditësimi i një regjistri me informacione për çdo formë të ndihmës shtetërore.	1.1. Përgatitja e një regjistri të ndihmës shtetërore në kuadër të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës.	KMK	Gjysma e dytë e vitit 2022	E pamaturuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar
Problemi 2: Dhënie e tepërur e koncesioneve, transparencë e pamjaftueshme e kontratave koncesionare dhe mekanizma të pamjaftueshëm të zhvilluar për përcaktimin e tarifës reale të koncesionit për lëndët e para të shfrytëzuara.								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Optimizimi i shfrytëzimit të pasurive natyrore në drejtim të mbrojtjes së mjedisit.	1.1. Përgatitja e një studimi fizibiliteti për përcaktimin e gjendjes së shfrytëzimit të burimeve natyrore sipas fushave.	ME	Gjysma e dytë e vitit 2021	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	E realizuar
	1.2. Miratimi i politikave dhe masave në drejtim të zbatimit të rekomandimeve të studimit të fizibilitetit.	ME Qeveria	Gjysma e dytë e vitit 2022	E pamaturuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	E realizuar
2. Rritja e transparencës në dhënien e koncesioneve.	2.1. Publikimi i kontratave të koncesioneve për shfrytëzimin e lëndëve të para.	ME MMPH MBPEU	Gjysma e dytë e vitit 2021– në kontinuitet	E pamaturuar	Në zhvillim e sipër	E përealizuar	E përealizuar	E realizuar
3. Zhvillimi i mekanizmave për përcaktimin e nivelit dhe arkëtimin e tarifës reale të koncesionit për lëndët e para të shfrytëzuara.	3.1. Analiza dhe rishikimi i nivelit të shumës së tarifës koncesionare dhe i shkallës së arkëtimit të saj.	ME MMPH MBPEU	Gjysma e parë e vitit 2021– në kontinuitet	E realizuar	E realizuar	E përealizuar	E përealizuar	E realizuar
	3.2. Zhvillimi i metodologjisë dhe mekanizmave për përcaktimin e një tarife reale koncesionare.	ME	Gjysma e dytë e vitit 2021	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	E përealizuar	Në zhvillim e sipër

4. Rritja e kontrollit gjatë shfrytëzimit të lëndëve të para.	4.1. Rritja e numrit të të punësuarve në shërbimet inspektuese.	ME MMPH	Gjysma e parë e vitit 2021	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E realizuar
	4.2. Zbatimi i trajnimeve për punonjësit e shërbimeve inspektuese kompetente.	MB	Gjysma e parë e vitit 2021	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
Problemi 3: Mungesa e regjistrave për pasurinë në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe NJVL-të								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Krijimi i një evidencë të unifikuar të pasurive të paluajtshme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.	1.1. Përditësimi i evidencës elektronike të pasurive të paluajtshme në pronësi shtetërore, si dhe të pasurive të paluajtshme në pronësi shtetërore që përdoren nga organet shtetërore dhe nga personat juridikë të themeluar nga shteti dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale.	AKP	Gjysma e parë e vitit 2021 –në kontinuitet	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër
	1.2 Sigurimi i transparencës duke integruar një opsion për kërkim të hapur të pasurisë në pronësi shtetërore në portalin e shpërndarjes së Agjencisë për Kadastër të Pasurive të Paluajtshme (sipas EIB, emrit të organit shtetëror, llojit të pasurisë së paluajtshme dhe kriterëve të tjera).	AKP	Gjysma e parë e vitit 2021 –në kontinuitet	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
2. Krijimi i një regjistri publikisht të qashtëm për automjetet motorike në pronësi të institucioneve të sektorit publik dhe njësite të vetëqeverisjes lokale	2.1 Regjistri ekzistues i automjeteve motorike që mbahet në MPB të përmirësohet me mundësinë që të dhënat të jenë publikisht të qasshme dhe të lehta për	MPB	Gjysma e dytë e vitit 2021	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër

(përveç automjeteve për qëllime të veçanta).	kërkim sipas institucioneve.							
Problemi 4: Përfshirje e pamjaftueshme e subjekteve më të vogla ekonomike në procesin e hartimit të politikave ekonomike dhe politikave të tjera relevante për komunitetin e biznesit								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Rritja e transparencës së procesit të krijimit të politikave ekonomike dhe politikave të tjera relevante për komunitetin e biznesit.	1.1. Ndryshimi i metodologjisë për vlerësimin e ndikimit të rregullativës (VNR) në drejtim të publikimit më të detajuar të arsyeve për miratimin e një zgjidhjeje të caktuar ligjore, propozimeve kryesore që kanë qenë objekt shqyrtimi (dhe propozuesve të tyre), si dhe ndikimit të zgjidhjes së zgjedhur në klimën ekonomike dhe komunitetin e biznesit.	MSHIA	Gjysma e dytë e vitit 2021	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
	1.2. Zbatimi i trajnimeve, mentorimit dhe mbështetjes për mikro dhe ndërmarrjet e vogla për ndërtimin e qëndrimeve dhe veprimit të përbashkët lidhur me politikat që ndikojnë në klimën ekonomike dhe kushtet e funksionimit të tyre në vend.	APH Sektori civil Asociacionet e biznesit	Gjysma e parë e vitit 2022 – në kontinuitet	E pamaturuar	E realizuar	E realizuar	E realizuar	E realizuar

Për tejkalimin e **Problemit 1: Mungesa e një regjistri për ndihmën e dhënë shtetërore për operatorët ekonomikë në pronësi të personave juridikë vendorë dhe të huaj**, është parashikuar një maasë e vetme. **Masa 1: Krijimi, publikimi dhe përditësimi i një regjistri me informacione për çdo formë të ndihmës shtetërore**, me një aktivitet të veteëm. *Aktivitet 1.1: Hartimi i regjistrit të ndihmës shtetërore në kuadër të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës*. Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2022**, ndërsa i njëjti është në kompetencë të **KMK-së**. Ky aktivitet, si edhe deri më tani, mbetet **“i parealizuar”**. KMK njoftoi se aktiviteti nuk është realizuar për shkak se hartimi/realizimi i regjistrit sjell implikime financiare për Komisionin, por edhe për shkak se në hartimin e tij janë të përfshira edhe institucione të tjera shtetërore (Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ministria e Financave).

Problemi 2: Dhënie e tepruar e koncesioneve, transparencë e pamjaftueshme e kontratave të koncesionit dhe mekanizma të pamjaftueshëm të zhvilluar për përcaktimin e tarifës reale të koncesionit për lëndët e para të ekspluatuar.

Masa 1: Optimizimi i shfrytëzimit të pasurive natyrore në drejtim të mbrojtjes së mjedisit përfshin aktivitetet në vijim:

- *Aktiviteti 1.1: Hartimi i një studimi fizibiliteti për përcaktimin e gjendjes së shfrytëzimit të burimeve natyrore sipas fushave*. Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2021**, ndërsa i njëjti është në kompetencë të MEMLP, në përputhje me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e LOPOASH-së. MEMLP njofton se aktiviteti është **“i realizuar”** në vitin 2025 përmes përgatitjes së Strategjisë për hulumtime gjeologjike dhe shfrytëzim të qëndrueshëm dhe shfrytëzim të mineraleve të Republikës së Maqedonisë së Veriut 2025–2045, e cila gjatë vitit ka qenë **“në zhvillim e sipër”** dhe është dorëzuar në Qeverinë e RMV-së (https://gsgovmk-my.sharepoint.com/:b:/g/personal/teodora_cvetkoska_energy_gov_mk/IQBQix1CgT1KS5KWaOYkrQ3SAcQh5BwtKxCnHuLchy2f9c?e=Siwnwj), ndërsa e njehta është miratuar më 27 janar 2026 dhe është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 17 nga 29.01.2026 (https://gsgovmk-my.sharepoint.com/:b:/g/personal/teodora_cvetkoska_energy_gov_mk/IQBnDIRx6BMqQYVz52fh-vjLASXL4fgYd-kmkZVR8jSewgl?e=QEZPVp).
- *Aktiviteti 1.2: Miratimi i politikave dhe masave në drejtim të përmbushjes së rekomandimeve nga studimi i fizibilitetit*. Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2022**, ndërsa i njëjti është në kompetencë të MEMLP, në përputhje me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e LOPOASH-së. MEMLP njofton se aktiviteti është **“i realizuar”** me Strategjinë e hartuar për hulumtime gjeologjike dhe shfrytëzim të qëndrueshëm dhe shfrytëzim të mineraleve të Republikës së Maqedonisë së Veriut 2025–2045, në të cilën janë përcaktuar politikat dhe masat për gjendjen e shfrytëzimit të burimeve natyrore, përkatësisht ato janë të strukturuar përmes tri fushave prioritare (ekonomia, mjedisi dhe socialja), përmes qëllimeve të përgjithshme dhe specifike, masave dhe aktiviteteve të përfshira në një plan aksional me një kornizë kohore të përcaktuar për zbatimin e masave.

Masa 2: Rritja e transparencës në dhënien e koncesioneve përfshin *Aktivitetin 2.1: Publikimi i kontratave të koncesionit për eksplatin e lëndëve të para*, i parashikuar për gjysmën e dytë të vitit 2022 – në kontinuitet, ndërsa i njëjti është në kompetencë të **MEMLP**, sipas raportimit të vitit të kaluar të MEP, në përputhje me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e LOPOASH-së. Në ueb-faqen e MEMLP-së janë të publikuara kontratat e skanuara të lidhura për koncesione për shfrytëzimin e mineraleve dhe ato vazhdojnë të publikohen në vazhdimësi (<https://energy.gov.mk/mk-MK/dokumenti/dogovori-za-koncesija>), prandaj aktiviteti vlerësohet si **“i realizuar”**.

Masa 3: Zhvillimi i mekanizmave për përcaktimin e nivelit dhe arkëtimin e tarifës reale të koncesionit për lëndët e para të shfrytëzuara përfshin dy aktivitete, si vijon:

- *Aktiviteti 3.1: Analiza dhe rishikimi i lartësisë së shumës së kompensimit të koncesionit dhe shkallës së arkëtimin të tij, i parashikuar për gjysmën e parë të vitit 2021 – në kontinuitet*, ka qenë në kompetencë të ME (MEP), por si edhe aktivitetet e mëparshme, tani është në kompetencë të MEMLP. Në këtë periudhë raportuese, MEMLP njofton se aktiviteti është “**i realizuar**”. Në bazë të një analize të detajuar është miratuar një Tarifor i ri për përcaktimin e lartësisë së kompensimit të koncesionit për kryerjen e hulumtimeve të detajuara gjeologjike dhe shfrytëzimin e mineraleve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 268/24) më 25.12.2024, me zbatim nga 01.01.2025, me të cilin është bërë rishikimi i shumës së kompensimit të koncesionit. Në kontinuitet monitorohet arkëtimi i kompensimit të koncesionit për përdorimin e hapësirës dhe për sasi të shitura të mineraleve të shfrytëzuara.
- *Aktiviteti 3.2: Zhvillimi i metodologjisë dhe mekanizmave për përcaktimin e një tarife reale të koncesionit*, i parashikuar për **gjysmën e dytë të vitit 2021**, ka qenë në kompetencë të ME (MEP), ndërsa nga viti 2024 është në kompetencë të MEMLP. Institucioni raporton se për përcaktimin e një tarife reale të koncesionit po hartohet një Tarifor, i cili buron nga Ligji për minerale. Gjatë përgatitjes së Tariforit, me qëllim përcaktimin e një tarife reale të koncesionit, bëhet analizë krahasuese në raport me çmimin e tregut të mineraleve, i cili është i ndryshueshëm në vendet e rajonit, si dhe në vendet e Evropës dhe botës (https://gsgovmk.my.sharepoint.com/:b:/g/personal/teodora_cvetkoska_energy_gov_mk/IQBlabj4FNAoSqKlZO_UVFzZAcQdCCwTWkep9IMuij0Kvss?e=X82twb). MEMLP thekson se procedura për hartimin e Ligjit për miniera është në zhvillim e sipër, në të cilin do të përcaktohet procedura për miratimin e Tariforit, me të cilin niveli i kompensimeve për dhënie e lejeve dhe koncesioneve për shfrytëzimin e mineraleve do të përcaktohet në varësi të llojit, sasisë, cilësisë, mënyrës së përpunimit të mineralit, shkallës së shfrytëzimit të tij dhe metodologjisë për klasifikimin e cilësisë së mermerëve dhe gurit ndërtimor e arkitektonik. Aktiviteti konsiderohet “**në zhvillim e sipër**” deri në miratimin e ligjit përkatës dhe përcaktimin e metodologjisë dhe mekanizmave për një tarifë reale të koncesionit.

Masa 4: Rritja e kontrollit gjatë shfrytëzimit të lëndëve të para sipas koncesioneve të dhëna gjithashtu përfshin dy aktivitete, si vijon:

- *Aktiviteti 4.1: Rritja e numrit të të punësuarve në shërbimet inspektuese*. Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e parë e vitit 2021 – në kontinuitet**, dhe i njëjti ka qenë në kompetencë të ME (MEP), ndërsa nga viti 2024 është në kompetencë të MEMLP. Institucioni raporton se aktiviteti për rritjen e numrit të të punësuarve në shërbimet inspektuese është “**i realizuar**”. Konkretisht, në vitin 2025, në Inspektoratin Shtetëror për Energjetikë, Miniera dhe Burime Minerale, i cili është në përbërje të MEMLP, janë punësuar edhe dy inspektorë shtesë, me ç'rast numri i përgjithshëm i të punësuarve në inspektorat arrin në 16 persona, prej të cilëve 13 janë inspektorë.
- *Aktiviteti 4.2: Zbatimi i trajnimeve për punonjësit në shërbimet kompetente inspektuese*. Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e parë e vitit 2021**, ndërsa i njëjti është në kompetencë të MSH-së. Edhe pse gjatë katër viteve të fundit MSH është shprehur se nuk është institucion përgjegjës, këtë vit raporton se aktiviteti është “**i realizuar**”. Në këtë drejtim, MSH njofton se janë realizuar të gjitha trajnimet e parashikuara për shërbimet kompetente inspektuese, por masa ka të bëjë me rritjen e kontrollit gjatë shfrytëzimit të lëndëve të para sipas koncesioneve të dhëna. Duke qenë se MSH në të vërtetë nuk ka kompetencë për këtë aktivitet, si dhe fakti që nuk ka dorëzuar program trajnimi të realizuar mbi të cilin KSHPK do të kishte pasqyrë për temat e trajnimeve, aktiviteti konsiderohet “**i përealizuar**”.

Problemi 3: Mungesa e regjistrave për pasurinë në pronësi të shtetit dhe NJVL-të

Masa 1: Krijimi i një evidencë të unifikuar të pasurisë së paluajtshme të Republikës së Maqedonisë së Veriut përfshin aktivitetet në vijim:


- *Aktiviteti 1.1: Përditësimi i evidencës elektronike të pasurisë së paluajtshme në pronësi shtetërore, si dhe të pasurisë së paluajtshme në pronësi shtetërore që përdoret nga organet shtetërore dhe personat juridikë të themeluar nga shteti dhe NJVL-të. Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e parë e vitit 2021 – në kontinuitet**, ndërsa i njëjti është në kompetencë të AKP-së. Ky aktivitet është “**në zhvillim e sipër**”, si edhe më parë. Sipas raportit, regjistri i pasurisë së paluajtshme në pronësi shtetërore është i krijuar, ndërsa përditësimi i tij varet nga korrektësia e institucioneve në dorëzimin e vendimeve për regjistrimin e së drejtës së pronësisë, vendimeve për dhënien e përdorimit të përhershëm të pasurive të paluajtshme, etj.*
- *Aktiviteti 1.2: Sigurimi i transparencës përmes integritetit të opsionit për kërkim të hapur të pasurisë shtetërore në portalin distributiv të Agjencisë për Kadastër të Pasurive të Paluajtshme (sipas BEI, emër i një organi shtetëror, llojit të pasurisë së paluajtshme dhe kriterëve të tjera). Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e parë e vitit 2021 – në kontinuitet**, ndërsa i njëjti është në kompetencë të AKP-së. Sipas raportit të dorëzuar nga AKP, ky aktivitet nuk është filluar fare dhe vlerësohet si “**i parealizuar**”.*

*Masa 2: Krijimi i një regjistri publikisht të qasshëm për automjetet në pronësi të institucioneve të sektorit publik dhe NJVL-të (përveç automjeteve për përdorime speciale) parashikon një aktivitet. Aktivitet 2.1: Përmirësimin e regjistrimit ekzistues të automjeteve motorike që mbahet në MPB, me mundësi që të dhënat të jenë publike dhe lehtësisht të kërkueshme sipas institucioneve. Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2021**, ndërsa i njëjti është në kompetencë të MPB-së. Ky aktivitet është “**në zhvillim e sipër**”. Sipas raportit, është përgatitur specifikimi teknik për zhvillimin e softuerit për Regjistrin e automjeteve (zgjidhje e plotë e integruar web me bazë të centralizuar të të dhënave), është përgatitur dokumentacioni i tenderit për zhvillimin e softuerit për Regjistrin e automjeteve dhe është shpallur tenderi për prokurimin e tij.*

Problemi 4: Përfshirje e pamjaftueshme e subjekteve më të vogla ekonomike në procesin e krijimit të politikave ekonomike dhe politikave të tjera relevante për komunitetin e biznesit. Për këtë problem është parashikuar një masë e vetme. Masa 1: Rritja e transparencës së procesit të krijimit të politikave ekonomike dhe politikave të tjera relevante për komunitetin e biznesit, e cila përfshin aktivitetet në vijim:


- *Aktiviteti 1.1: Ndryshimi i Metodologjisë për vlerësimin e ndikimit të rregullativës (VNR) në drejtim të publikimit më të detajuar të arsyeve për miratimin e një zgjidhjeje të caktuar ligjore, propozimeve kryesore që kanë qenë objekt shqyrtimi (dhe propozuesve të tyre) si dhe ndikimit të zgjidhjes së përzgjedhur në klimën ekonomike dhe komunitetin e biznesit. Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2021**, ndërsa i njëjti është në kompetencë të MSHIA (MAP). Ashtu si në vitet e kaluara, ky aktivitet ka statusin “**i parealizuar**”. MAP njofton se aktiviteti është në zhvillim e sipër. Sipas Strategjisë për reformën e administratës publike 2023–2030 parashikohet përgatitja e akteve të reja për VNR (Metodologjia për VNR, Udhëzuesi për mënyrën e veprimit të ministrive në procesin e zbatimit të VNR-së dhe Vendimi për formën dhe përmbajtjen e Raportit për VNR). Megjithatë, është e qartë se nuk janë ndërmarrë aktivitete për ndryshimin e metodologjisë përkatëse.*
- *Aktiviteti 1.2: Zbatimi i trajnimeve, mentorimit dhe mbështetjes për mikro dhe ndërmarrjet e vogla për ndërtimin e qëndrimeve të përbashkëta dhe përfaqësim në lidhje me politikat që ndikojnë në klimën ekonomike dhe kushtet e punës së tyre në vend. Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e parë e vitit 2022 – në kontinuitet**, ndërsa i njëjti është në kompetencë të APH-së. Ky aktivitet është “**i realizuar**” edhe në këtë periudhë vlerësimi, si edhe në vitet e mëparshme. Në vitin 2025, nga ana e operatorit ekonomik të ngarkuar me realizimin e punësive për ngritjen e vetëdijes për digjitalizim të ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, janë organizuar 6 punëtori me gjithsej 100 pjesëmarrës në qytetet: më 07.11.2025 në Manastir, më 12.11.2025 në Shtip, më 18.11.2025 në Strumicë, më 18.11.2025 në Ohër, më 26.11.2025 në Prilep dhe më 28.11.2025 në Kumanovë. Profili i pjesëmarrësve ka qenë i*

larmishëm – përfaqësues të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, të rinj dhe gra sipërmarrëse. Përzgjedhja e përmbajtjeve tematike është fokusuar në nevojat aktuale të ekonomisë – digjitalizimi.




Fotografia 32: Shkalla e përgjithshme e realizimit në sektorin përkatës

Nga gjithsej 13 aktivitete të parashikuara në Strategjinë për sektorin e ekonomisë dhe biznesit, 6 aktivitete janë realizuar (46%), 4 aktivitete janë të porealizuara (31%), ndërsa 3 aktivitete janë “në zhvillim e sipër” (23%).



Fotografia 33: Statusi i aktiviteteve sipas periudhës së vlerësimit



Fotografia 34: Statusi i përgjithshëm i aktiviteteve sipas institucioneve

- MEMLP ka 6 aktivitete, prej të cilave 5 janë të realizuara, ndërsa një është në zhvillim e sipër.
- MAP ka një aktivitet i cili është i porealizuar.
- MPB ka një aktivitet në zhvillim e sipër.
- AKP ka dy aktivitete, prej të cilave një është në zhvillim e sipër dhe një është i porealizuar.
- APH ka një aktivitet i cili është i realizuar.
- KMK ka një aktivitet i cili është i porealizuar.
- MSH ka një aktivitet i cili është i porealizuar.

16. SEKTORI I NP DHE SHA NË PRONËSI TË SHTETIT DHE NJVL-të

Përshkrimi i sektorit

Në lidhje me sektorin e NP-ve dhe SHA-ve në pronësi të shtetit dhe NJVL-ve, në Strategji janë përcaktuar këto tri probleme prioritare:

- 1) Mungesa e informatave zyrtare dhe të unifikuara për personat juridikë në pronësi të shtetit dhe NJVL-të;
- 2) Mungesa e një qasjeje sistematike për parandalimin e korrupsionit në ndërmarrjet në pronësi të shtetit dhe NJVL-të;
- 3) Kornizë e papërshtatshme ligjore për funksionimin e ndërmarrjeve në pronësi të shtetit dhe NJVL-të.

Për realizimin e masave dhe aktiviteteve të parapara për tejkalimin e problemeve në sektorin e ekonomisë dhe biznesit, përgjegjëse janë institucionet e mëposhtme:

- 1) Qeveria,
- 2) ME,
- 3) KSHPK,
- 4) MVL,
- 5) MF,
- 6) Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: RQRMV).

Shkalla e realizimit të aktiviteteve

Në sektorin e NP-ve dhe SHA-ve në pronësi shtetërore dhe në pronësi të NJVL-ve janë konstatuar tre probleme, për tejkalimin e të cilave, me Planin e Veprimit të Strategjisë në periudhën raportuese janë paraparë 3 masa dhe 5 aktivitete.

Në bazë të të dhënave të marra dhe analizës së bërë lidhur me realizimin e masave dhe aktiviteteve në sektorin e NP-ve dhe SHA-ve në pronësi shtetërore dhe në pronësi të NJVL-ve, gjendja është si vijon:

Problemi 1: Mungesa e informatave zyrtare dhe të unifikuara për personat juridikë në pronësi të shtetit dhe të NJVL-të								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Hartimi i një baze të dhënash unike për personat juridikë të themeluar sipas Ligjit për ndërmarrjet publike dhe Ligjit për shoqëritë tregtare, ku shteti dhe vetëqeverisja lokale janë pronarë ose kanë pjesëmarrje pronësore.	1.1. Krijimi i një regjistri dhe përditësimi i tij me të dhëna për pronësinë dhe rezultatet financiare të ndërmarrjeve.	ME MVL MF RQRMV	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar
Problemi 2: Mungesa e një qasjeje sistematike për parandalimin e korrupsionit në ndërmarrjet në pronësi të shtetit dhe NJVL-të								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Vendosja dhe zbatimi i një programi antikorrupsion për ndërmarrjet në pronësi dominuese të shtetit dhe të njësive të vetëqeverisjes lokale.	1.1 Përgatitja e një programi antikorrupsion për ndërmarrjet në pronësi dominuese të shtetit dhe të njësive të vetëqeverisjes lokale.	KSHPK	Gjysma e dytë e vitit 2023	E pamaturuar	E pamaturuar	E realizuar	/	/
	1.2 Miratimi i programit antikorrupsion për ndërmarrjet në pronësi dominuese të shtetit dhe të njësive të vetëqeverisjes lokale nga Qeveria.	Qeveria	Gjysma e parë e vitit 2024	E pamaturuar	E pamaturuar	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar
	1.3 Krijimi i një monitorimi efikas të zbatimit të programit.	Qeveria	Gjysma e dytë e vitit 2024- në kontinuitet	E pamaturuar	E pamaturuar	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar
Problemi 3: Kornizë ligjore e papërshtatshme për funksionimin e ndërmarrjeve në pronësi të shtetit dhe NJVL-të								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Krijimi i një kornize të vetme ligjore për funksionimin e shoqërive tregtare në pronësi dominuese të shtetit dhe ndërmarrjeve publike të	1.1 Analizë krahasuese e legjislacionit me vendet e rajonit dhe vendet anëtare të BE-së në drejtim të identifikimit të zgjidhjeve të mira.	ME	Gjysma e dytë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar	E parealizuar

themeluara nga Qeveria dhe vetëqeverisja lokale.	1.2 Miratimi i një ligji të vetëm me të cilin do të rregullohet funksionimi i këtyre kategorive të subjekteve juridike.	ME	Gjysma e parë e vitit 2023	E pamaturuar	E pamaturuar	E perealizuar	E perealizuar	Në zhvillim e sipër
--	---	----	----------------------------	--------------	--------------	---------------	---------------	---------------------


Për **Problemin 1: Mungesa e informatave zyrtare dhe të unifikuara për personat juridikë në pronësi të shtetit dhe NJVL-të, është paraparë Masa 1: Hartimi i një baze të dhënash unike për personat juridikë të themeluar sipas Ligjit për ndërmarrjet publike dhe Ligjit për shoqëritë tregtare, ku shteti dhe vetëqeverisja lokale janë pronarë ose kanë pjesëmarrje pronësore, për të cilën është paraparë një aktivitet. Aktiviteti 1.1: Krijimi i një regjistri dhe përditësimi i tij me të dhëna për pronësinë dhe rezultatet financiare të ndërmarrjeve, me afat realizimi në gjysmën e parë të vitit 2022 dhe në kompetencë të ME (MEP). Ky aktivitet mbetet “i parealizuar” si më parë. ME (MEP) njofton se aktualisht ekziston një projekt-ligj i përgatitur që parashih krijimin e një Regjistri, në të cilin nuk janë planifikuar të dhëna për pronësinë, me udhëzimin që të dhënat për pronësinë do të vendosen në një regjistrë tjetër.**

Për **Problemin 2: Mungesa e një qasjeje sistematike për parandalimin e korrupsionit në ndërmarrjet në pronësi të shtetit dhe NJVL-të, gjithashtu është paraparë Masa 1: Vendosja dhe zbatimi i një programi antikorrupsion për ndërmarrjet në pronësi dominuese të shtetit dhe NJVL-të.**

- *Aktiviteti 1.2: Miratimi i programit për antikorrupsion për ndërmarrjet në pronësi dominuese të shtetit dhe NJVL-të nga Qeveria. Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë gjysma e parë e vitit 2024, ndërsa është në kompetencë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut informon se Programi për Antikorrupsion i miratuar nga KSHPK në vitin 2023 nuk është miratuar brenda afatit të parashikuar, prandaj aktiviteti mbetet “i parealizuar”.*
- *Aktiviteti 1.3: Krijimi i një monitorimi efikas të zbatimit të programit. Afati për realizimin e këtij aktiviteti është gjysma e dytë e vitit 2024 – në kontinuitet, dhe i njëjti është nën kompetencë të qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Duke qenë se Programi për Antikorrupsion nuk është miratuar brenda afatit të parashikuar, ky aktivitet mbetet “i parealizuar”.*


Për **Problemin 3: Kornizë ligjore e papërshtatshme për funksionimin e ndërmarrjeve në pronësi të shtetit dhe NJVL-ve, është paraparë Masa 1: Krijimi i një kornize të unifikuar ligjore për funksionimin e shoqërive tregtare në pronësi dominuese të shtetit dhe ndërmarrjeve publike të themeluara nga Qeveria dhe vetëqeverisja lokale, e cila përfshin këto aktivitete:**

- *Aktiviteti 1.1: Analizë krahasuese e legjislacionit me vendet e rajonit dhe shtetet anëtare të BE-së, me qëllim identifikimin e zgjidhjeve të mira, e paraparë për gjysmën e dytë të vitit 2022 dhe në kompetencë të MEP. Institucioni raporton se aktiviteti mbetet “i parealizuar”, megjithëse në raport theksohet se është kryer një analizë krahasuese para përgatitjes së draft-strategjisë dhe draft-ligjit për ndërmarrjet publike dhe shoqëritë tregtare.*
- *Aktiviteti 1.2: Miratimi i një ligji të unifikuar me të cilin do të rregullohet funksionimi i këtyre kategorive të subjekteve juridike. Afati për realizimin e këtij aktiviteti është gjysma e parë e vitit 2023 - në kontinuitet, ndërsa është në kompetencë të MEP. Ky aktivitet ka qenë i vlerësuar si “i parealizuar”, por në vitin 2025 MEP ka kryer një analizë krahasuese, pas së cilës është përgatitur një draft-strategji dhe draft-ligj për ndërmarrjet publike dhe shoqëritë tregtare në pronësi shtetërore, me të cilat synohet rregullimi i funksionimit të këtyre subjekteve juridike. Megjithatë, këto nuk i përfshijnë ndërmarrjet publike dhe shoqëritë tregtare të themeluara nga vetëqeverisja lokale, përkatësisht komunat dhe Qyteti i Shkupit. Për këtë arsye, aktiviteti konsiderohet se është “në zhvillim e sipër”.*




Fotografia 35: Shkalla e përgjithshme e realizimit në sektorin përkatës

Nga gjithsej 6 aktivitete të parashikuara në Strategji për sektorin e NP dhe SHA në pronësi shtetërore dhe në pronësi të NJVL, një aktivitet është i realizuar (16%), katër aktivitete nuk janë realizuar (67%), ndërsa një aktivitet është në zhvillim e sipër (16%).



Fotografia 36: Statusi i aktiviteteve sipas periudhës së vlerësimit



Fotografia 37: Statusi i përgjithshëm i aktiviteteve sipas institucioneve

- MEP ka gjithsej tre aktivitete, prej të cilave dy nuk janë realizuar, ndërsa një është në zhvillim e sipër.
- Për KSHPK është paraparë një aktivitet i cili është i realizuar.
- Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka dy aktivitete të përfunduar.

17. SEKTORI PËR MEDIA DHE SHOQËRI CIVILE

Përshkrimi i sektorit

Në lidhje me sektorin e mediave dhe shoqërisë civile, në Strategji janë përcaktuar këto tre probleme prioritare:

- 1) Mungesë e transparencës së mjaftueshme të institucioneve të sektorit publik për bashkëpunimin me media, portale interneti, agjenci marketingu dhe punonjës të medias;
- 2) Mungesë e bazës ligjore për rregullimin dhe evidencën e mediave online;
- 3) Forcimi i transparencës së institucioneve gjatë planifikimit të mjeteve për financimin e shoqërisë civile, si dhe rritja e llogaridhënies për realizimin e tyre.

Për realizimin e masave dhe aktiviteteve të parashikuara për tejkalimin e problemeve në sektorin e mediave dhe shoqërisë civile, përgjegjëse janë institucionet e mëposhtme:

- 1) Qeveria,
- 2) MSHIA,
- 3) MD,
- 4) MF,
- 5) Shoqata e Gazetarëve (në vijim: SHG),
- 6) Këshilli për Etikën në Media (në vijim: KEM),
- 7) Oda Ekonomike.

Shkalla e realizimit të aktiviteteve.

Në sektorin e mediave dhe shoqërisë civile janë konstatuar tre probleme, për tejkalimin e të cilave, me Planin e Veprimit të Strategjisë në periudhën raportuese janë paraparë 4 masa dhe 5 aktivitete.

KSHPK ka kryer verifikimin dhe analizën e të dhënave lidhur me realizimin e masave dhe aktiviteteve në sektorin e mediave dhe shoqërisë civile dhe ka përcaktuar gjendjen e mëposhtme:

Problemi 1: Mungesë e transparencës së mjaftueshme të institucioneve të sektorit publik për bashkëpunimin me media, portale interneti, agjenci marketingu dhe punonjës të medias								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Vendosja e detyrimit për institucionet e sektorit publik që të dorëzojnë raporte për kontratat e lidhura dhe të realizuara me media, portale interneti, agjenci marketingu dhe punonjës mediatikë.	1.1 Ndryshime në Ligjin për ASHMAA në lidhje me vendosjen e detyrimit për institucionet e sektorit publik dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale që të publikojnë në mënyrë transparente raportet për kontratat e lidhura dhe të realizuara të çdo lloji me media, portale interneti, agjenci marketingu dhe punonjës mediatikë.	MSHIA	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E parealizuar
2. Përmirësimi i kriterëve për dhënien e ndihmës shtetërore për mediat e shtypura.	2.1 Analizë e kriterëve ekzistues për dhënien e ndihmës shtetërore.	Qeveria	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E realizuar	/
	2.2 Ndryshimi i vendimit për programin e mbështetjes për mediat e shtypura dhe shpërndarjen e mediave të shtypura.	Qeveria	Gjysma e dytë e vitit 2022	E pamaturuar	E parealizuar	Në zhvillim e sipër	E realizuar	/
Problemi 2: Forcimi i vetërregullimit në lidhje me mediat online								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Forcimi i vetërregullimit në lidhje me mediat online	1.1. Analiza e gjendjes së mediave online në lidhje me profesionalizmin dhe integritetin në punën e tyre	SHGM dhe KEMM	Gjysma e dytë e vitit 2021	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E parealizuar	E parealizuar	E realizuar
	1.2. Përcaktimi i mekanizmave për forcimin e vetërregullimit të mediave online	SHGM dhe KEMM	Gjysma e dytë e vitit 2021	E realizuar	/	/	/	/

2. Përmirësimi i regjistrimit të mediave profesionale online	2.1. Miratimi dhe zbatimi i praktikave pozitive ndërkombëtare për përmirësimin e regjistrimit të mediave profesionale online	SHGM dhe KEMM	Gjysma e dytë e vitit 2021 – në kontinuitet	E realizuar	Në zhvillim e sipër	E përealizuar	E realizuar	E realizuar
Problemi 3: Forcimi i transparencës së institucioneve gjatë planifikimit të mjeteve për financimin e organizatave të shoqërisë civile, si dhe rritja e llogaridhënies për realizimin dhe efektet e projekteve								
Masa	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Afati i realizimit	Statusi 2021	Statusi 2022	Statusi 2023	Statusi 2024	Statusi 2025
1. Forcimi i transparencës së institucioneve gjatë planifikimit të mjeteve për financimin e OQ-ve, si dhe i llogaridhënies për realizimin dhe efektet e projekteve	1.1. Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Shoqatat dhe Fondacionet në drejtim të përcaktimit të detyrimit për krijimin e një baze të vetme të të dhënave me informacione për mjetet e ndara dhe efektet e projekteve për të gjitha OQ-të që marrin mjete nga institucionet publike dhe NJVL-të	MD MF MSHIA	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E përealizuar	Në zhvillim e sipër
	1.2. Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Shoqatat dhe Fondacionet në drejtim të përcaktimit të detyrimit për institucionet publike dhe NJVL-të për përditësimin e rregullt të një baze të vetme të të dhënave	MD MF MSHA	Gjysma e parë e vitit 2022	E pamaturuar	Në zhvillim e sipër	Në zhvillim e sipër	E përealizuar	Në zhvillim e sipër

Problemi 1: Mungesë e transparencës së mjaftueshme të institucioneve të sektorit publik për bashkëpunimin me media, portale interneti, agjenci marketingu dhe punonjës në media.

Masa 1: Krijimi i detyrimit për institucionet e sektorit publik që të dorëzojnë raporte për kontratat e lidhura dhe të realizuara me media, portale interneti, agjenci marketingu dhe punonjës në media, përfshin tre aktivitete, prej të cilave dy janë realizuar vitin e kaluar. Aktiviteti i mbetur është Aktiviteti 1.1: *Ndryshime në Ligjin për ASHMAA në lidhje me vendosjen e detyrimit për institucionet e sektorit publik dhe NJVL-të që të publikojnë në mënyrë transparente raportet për kontratat e lidhura dhe të realizuara të çdo lloji me media, portale interneti, agjenci marketingu dhe punonjës të medias.* Afati për realizimin e kësaj aktiviteti ka qenë **gjysma e parë e vitit 2022**, dhe është në kompetencë të **MSHIA (MTD)**. Aktiviteti mbetet **“i parealizuar”**. MTD njofton se në dhjetor të vitit 2025 ka nisur procesin e harmonizimit të legjislacionit vendor me atë evropian, në të cilin do të punohet në përgatitjen e Strategjisë për zhvillimin e sektorit të mediave me Plan Veprimi, si dhe transpozimin e Aktit Evropian për Lirinë e Medias (European Media Freedom Act) në legjislacionin e brendshëm. Gjithashtu, theksohet se në këtë proces do të merren parasysh rekomandimet, masat dhe aktivitetet e përfshira në fushën 5.13 Media dhe shoqëri civile.

Problemi 2: Forcimi i vetërregullimit në lidhje me mediat online.

Masa 1: Forcimi i vetërregullimit në lidhje me mediat online përfshin dy aktivitete, prej të cilave i dyti është realizuar në vitin 2021, dhe atë:

- Aktiviteti 1.1: *Analizë e gjendjes së mediave online në lidhje me profesionalizmin dhe integritetin në punën e tyre, me afat realizimi në gjysmën e dytë të vitit 2021, në kompetencë të SHGM-së.* Ky aktivitet është **“i realizuar”**. Megjithatë SHGM nuk ka dorëzuar raport për aktivitetin, pas kërimit dhe analizës së dokumenteve të disponueshme në fushën e mediave online dhe profesionalizmit dhe integritetit në punën e tyre, rezulton se janë kryer disa analiza të funksionimit të mediave online, veçanërisht në aspektin e profesionalizmit dhe integritetit. Analiza, udhëzues dhe rekomandime janë të disponueshme në linqet në vijim: https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/202401/media_integrity_guide_mk_final_0.pdf; znz.org.mk/wp-content/uploads/2023/11/MK-Fact-Finding-PFM-Report-251023-web-final.pdf; <https://semm.mk/nasoki-za-etichko-izvestuvanje-na-onlajn-mediumite/>.


Masa 2: Përmirësimi i regjistrimit të mediave profesionale online ka një aktivitet:

Aktiviteti 2.1: Miratimi dhe zbatimi i praktikave pozitive ndërkombëtare për përmirësimin e regjistrimit të mediave profesionale online. Afati për realizimin e këtij aktiviteti ka qenë **gjysma e dytë e vitit 2021 – në kontinuitet**, në kompetencë të SHGM-së. Ky aktivitet është **“i realizuar”** për periudhën raportuese. SHGM nuk ka dorëzuar raport për këtë periudhë. Pas verifikimit në faqen e ASHMAA, shihet qartë se në qershor 2025 është miratuar Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e aplikimit për regjistrimin e botuesve të mediave online–portaleve të internetit dhe për mënyrën e mbajtjes së regjistrimit të botuesve të mediave online–portaleve të internetit. Kushtet që duhet t’i përmbushin botuesit për t’u regjistruar në këtë regjistrim janë të përcaktuara në nenin 5 të kësaj Rregulloreje.

- Të ketë regjistruar veprimtarinë në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Të ketë seli dhe redaksi në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- Të ketë të regjistruar në emrin e vet një domen interneti maqedonas .mk ose .mkd; dhe
- Të përmbushë kushtet minimale të stafit të përcaktuara në nenin 5, paragrafët 11 dhe 12 të Ligjit për mediat.


Për tejkalimin e **Problemit 3: Forcimi i transparencës së institucioneve gjatë planifikimit të mjeteve për financimin e organizatave të shoqërisë civile, si dhe rritja e llogaridhënies për realizimin dhe efektet e projekteve**, është paraparë **Masa 1: Forcimi i transparencës së**

institucioneve gjatë planifikimit të mjeteve për financimin e organizatave të shoqërisë civile, si dhe llogaridhënia për realizimin dhe efektet e projekteve e cila përfshin Aktivitetin 1.1: Ndryshime dhe plotësime të Ligjit për shoqatat dhe fondacionet në drejtim të përcaktimit të detyrimit për krijimin e një baze të dhënash unike me informacione për fondet e ndara dhe efektet e projekteve për të gjitha organizatat e shoqërisë civile që marrin fonde nga institucionet publike dhe NJVL-të, si dhe Aktivitetin 1.2: Ndryshime dhe plotësime të Ligjit për shoqatat dhe fondacionet në drejtim të përcaktimit të detyrimit për institucionet publike dhe NJVL-të për përditësimin e rregullt të bazës së të dhënave të vetme. Afati për realizimin e të dy aktiviteteve ka qenë **gjysma e parë e vitit 2022**, në kompetencë të MD-së. Institucioni raporton se është përgatitur një draft i ri i Ligjit për shoqatat dhe fondacionet, i cili është publikuar në RVKE, ku parashikohen dispozita në drejtim të forcimit të transparencës së institucioneve gjatë planifikimit të fondeve për financimin e organizatave të shoqërisë civile, si dhe llogaridhënies për realizimin dhe efektet e projekteve. Për këtë arsye, të dy aktivitetet kanë statusin “**në zhvillim e sipër**”.




Fotografia 38: Shkalla e përgjithshme e realizimit në sektorin përkatës

Nga gjithsej 8 aktivitete të parashikuara në Strategji për sektorin e mediave dhe shoqërisë civile, 5 aktivitete janë të realizuara (62%), një aktivitet nuk është i realizuar (13%), ndërsa dy aktivitete janë në zhvillim e sipër (25%).



Fotografia 39: Statusi i aktiviteteve sipas periudhës së vlerësimit



Fotografia 40: Statusi i përgjithshëm i aktiviteteve sipas institucioneve

- Për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut janë paraparë dy aktivitete të cilat janë të realizuara.
- Për SHGM-në janë paraparë tre aktivitete të cilat janë të realizuara.
- Për MD janë paraparë dy aktivitete të cilat janë në zhvillim e sipër.